

APOSTOL BARKO MALËSHOVA

Shqiptari i madh, që punoi, luftoi dhe, më në fund,

ra dëshmor për Gjuhën Shqipe e për Shqipërinë.

Nga Gjokë dabaj

2013-2017

~~~~~~

“Hero është ai që ka dhënë jetën e tij

për diçka më të madhe se vetëvetja.

(Xhozef Kampbell)

~~~~~~

N Ë V E N D T Ë H Y R J E S

Gjoka nuk është vetëm autori i këtij libri. Ai është dhëndri i Malëshovës sime, i fisit tim, i njerëzvet të mi.

Është një shkrimtar i mirënjohur. Në këtë libër kushtuar një rilindësi të mirëfilltë, siç është Apostol Barko, unë i vë këtij autori notën maksimale. Ka shkruar të vërtetën, ka thënë atë që duhej thënë, ka shumë të tjera që duhen shkruar dhe Gjoka e thotë bukur: “Le të bëjë dikush një libër më të mire”.

Si dhëndër, si djalë, si mik dhe si njeri me mend, e falenderoj për librin që na e përcolli. Vërtet ke qitur në shesh virtytet e Apostol Barkos, njërit prej përfaqësuesvet më të mirë të Malëshovës, midis dhjetëra të tjerëve që i kemi në Laskaj, në Nanaj, në Dafaj, Tytaj dhe Kano.

Kemi shumë, flasim pak.

Gjokë, falemnderit për librin! Të tjerë që dine të shkruajnë, le të bëjnë diçka edhe më të mirë!

Të lumtë pena! Miku dhe recenzenti yt, Trifon Dafa.

26.12.2016

P A R A TH Ë N I E

Shtytjet kryesore që më kanë motivuar për të shkruar këtë libër, ishin 2.

E para: Apostol Barko-Malëshova ka qenë një patriot ndër më të merituarit, megjithkëtë, një libër për të ende nuk ishte shkruar. Duhej shkruar, të paktën një libër përkujtues për atë njeri, të cilit, ndonëse e pat shkrirë jetën për Atdhe dhe, në fund, mbetur edhe pa varr, Atdheu ende s'ia kish kushtuar as edhe një rrasë përkujtuese.

E dyta, unë jam dhëndër në fisin Barkaj dhe, me qenë se merrem me letrat, më takonte ta shkruaja këtë libër, sigurisht me ndihmën e sime shoqeje, mbesë e patriotit, në mënyrë që fëmijët tanë dhe nipërit tanë, të mund ta njihnin më mirë njërin prej paraardhësvet të vet, me të cilin ata duhet të krenohen dhe të cilit do të ish mire, do të ish e dëshirueshme, t'i ngjanin.

Apostol Barko-Malëshova bën pjesë në Panteonin e atyre të krishterëve tanë, të Jugut dhe të Veriut, të cilët e kishin kuptuar se Kombi ynë mund të rilindte vetëm duke bashkuar mendjen dhe shpirtin me atë pjesë të myslimanëvet shqiptarë që kishin mbetur atdhedashës dhe që vazhdonin të shtoheshin dita-ditës. Kombi ynë do të mund të formësohej, konsolidohej dhe përjetësohej, vetëm dhe vetëm duke mos u mbështetur në përkatësitë fetare. Këtë do të duhej ta kuptonte, jo vetëm pjesa jonë myslimane, por edhe pjesa jonë e krishterë, e cila i pat rezistuar me aq

shumë sakrifica pushtuesit osman në disa shekuj. Kish filluar kjo filozofi e jona kombëtare, qysh me Gjon Buzukun, Pjetër Budin, Pjetër Bogdanin, a ndoshta më parë, dhe kish ardhur duke u mbrujtur e rrënjosur në vetëdijen e bartësvet të saj, aq sa ata qenë bindur se, për atë ide, ia vlente edhe të flijoheshe. Dhe u flijuan, njëri pas tjetrit, një plejadë e tërë: Që nga Naum Veqilharxhi, Koto Hoxhi, Pandeli Sotiri, Anastas Kullurioti, Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Themistokli Gërmenji, e deri te ky, për të cilin po shkruajmë sot, si dhe të tjerë që do të vinin pas këtij.

Apostol Barko-Malëshova (1874-1926, 53 vjet jetë) është pjesë e lavdisë së Jugut tonë, por është edhe viktimë e tragjedisë, si të Jugut, ashtu edhe të krejt Kombit Shqiptar.

Pjesë e lavdisë, sepse veproi në të njëjtën kohë, në të njëjtën linjë dhe me të njëjtën gatishmëri sakrifice, me Papa Kristo-Negovanin (1875-1905), Spiro Bellkamenin (1885-1912), Petro Nini-Luarasin (1865-1911), Themistokli Gërmenjin (1871-1917), Mihal Gramenon (1871-1931). Po të mos kishin vepruar ata në atë mënyrë dhe me aq vetëmohim, do kuptuar qartë që, ajo hapësirë e Shqipërisë së Jugut, që u përfshi më 1913-n brenda kufijvet të shtetit shqiptar, do të kish mbetur jashtë kufijvet të saj, siç edhe mbetën nën sundimin grek hapësirat e tjera të Jugut tonë. Dhe, nëse do të kishin mbetur edhe ato hapësira tonat jashtë shtetit të 1913-s, atëherë zor se do të mund të kishim një shtet shqiptar vetëm me Veriun. Aq më tepër, kur dihet se Veriun e kanë tejgjymtuar keqas pushtuesit që vinin nga ana e veriut dhe donin ende ta gjymtonin.

Apostol Barko-Malëshova e të tjerët, janë viktima të tragjedisë sonë, sepse, formula e Rilindjes sonë, shprehur në 2 vargjet e Pashko Vasë-Shkodranit, nuk funksionoi dot thuajse në gjysmën e Shqipërisë Jugore. Atje nuk u bashkuan dot të krishterë e myslimanë, sado që, për këtë, pat përpjekje e sakrifica të mëdha. Kisha Ortodokse Greke dhe shteti grek, arritën t'i vënë një shumicë të krishterësh shqiptarë të Çamërisë, Janinës, Konicës, Negovanit, Kosturit, Follorinës, kundër myslimanëvet shqiptarë. Kjo është tragjedia!

Historiografia jonë, midis së cilës edhe ky fragment i kësaj historiografie, ky jetëshkrim i shkurtër i Apostol Barko-Malëshovës, ka për detyrë t'i nxjerrë dhe t'i

shpjegojë arsyet: Pse nuk funksionoi edhe më në Jug formula jonë rilindëse “Myslimanë e të krishterë, jemi një!” dhe pse u rrënua aq keq etniteti ynë i krishterë, filluar nga Preveza e deri në Follorinë?! Ç’qe ajo hata e madhe, ajo mynxyrë, që na e çoi drejt rrëgjimit, drejt humbjes, drejt zhdukjes së plotë, atë kulturë dhe atë histori tonën dhjetërashekullore molose, thesprote e lashtomaqedone, pra, të pjesës sonë ortodokse të Çamërisë e të visevet të tjerë jugorë?!

***

Një kujdes të veçantë m’u desh të tregoja, tek po shkruaja këtë libër, edhe ndaj një të vërtete të bukur, por që, gjithsesi, nuk duhej neglizhuar. Të shkruash një libër për një malëshovit, nuk është aspak lehtë. Arsyeja është, sa kënaqësishkaktuese, aq edhe turbulluese. Malëshova ka me dhjetëra shkrimtarë , Malëshova ka shumë poetë. Do të mund të thuhej: sa malëshovitë ka, aq ka edhe poetë. Malëshova ka shumë autorë librash, të cilët, fatmirësisht, sa vijnë e po shtohen. Kjo mori njerëzish të arsimuar dhe të ditur, është e gatshme të të shikojë e peshojë çdo fjalë që ke shkruar, të ta diskutojë çdo gjë që ke thënë dhe, pasojisht, të shkruash një libër për një malëshovit, duke mos qenë vetë malëshovit, jo vetëm është e vështirë, por është edhe e rrëzikshme.

Problemi nuk ish, si do ta prisnin malëshovitët këtë libër, shkruar prej një shestanasi, dhëndër në Malëshovë. Problemi ish: A do të mund t’u përgjigjesha unë kërkesavet të larta intelektuale të asaj krahine?!

Gj.D.

KRAHINA E MALËSHOVËS

Malëshova është një krahinë malore që shtrihet në pjesët perëndimore të malit të Dhëmbelit. Në Perëndim Malëshova ka përballë vargmalin e Lunxhërisë, i cili fillon në Veri me Golikun. Goliku ngrihet midis lumit Drino dhe Lumit të Zagorisë dhe rri i varur përsipër lumit Vjosë. Vetë Dhëmbeli, pra, edhe Malëshova, gjenden në krah të majtë të Lumit Vjosë, duke pasur qytetin e Përmetit në Juglindje, ndërsa qytezën e Këlcyrës në Verilindje. Në Veri të Malëshovës rrjedh prapë Vjosa, duke

u përshkuar nëpër Grykën shumë të thellë të Këlcyrës. Në Jug të Malëshovës shtrihet Lugina e Zagorisë, prej nga buron Lumi apo Përroi i Zagorisë, që, siç thamë, rrjedh edhe nëpër Malëshovë dhe derdhet në Vjosë, mu aty ku Gryka e Këlcyrës është më e thella.

Ashtu siç ndodh në shumë emërtime krahinash, edhe këtu emërtimi ***Malëshovë*** duhet marrë në 2 kuptime: Malëshovë në kuptimin e ngushtë dhe Malëshovë në kuptimin e saj të zgjeruar. Në kuptimin e ngushtë merret vetëm fshati Malëshovë me 4 lagje të tijat. Ndërsa në kuptimin e gjërë, si krahinë, nën emërtimin Malëshovë, përfshihen edhe fshatrat Limar, Leskaj, Kala e, sipas disavet, në po këtë krahinë hyjnë edhe Mbrezhdani, Grabova e Argova. (Krs.gaz."***Malësh***." korr. 2006, f.1) Ka mundësi, madje edhe Peshtani t'i përkasë të njëjtit areal, sado që ai administrativisht i takon Tepelenës. Duke qenë se, në pikëpamje gjeomorfologjike, nuk ka ndonjë kufi natyror midis Zagorisë dhe krahinës së Malëshovës, përkundrazi, të 2-ja këto treva i bashkon pjerrësia e Lumit të Zagorisë, kjo krahinë, thuhet, ka qenë quajtur edhe Zagori e Poshtme.

Lagjet e fshatit Malëshovë

Duke pasur parasysh që Apostol Barko-Malëshova i takon Malëshovës në kuptimin më të ngushtë, ne do të përqëndrohemi tani pikërisht këtu.

Fshati Malëshovë, dmth Malëshova në kuptimin e ngushtë, jo në kuptimin krahinor, përbëhet nga 4 lagje: Lagjja GROPË . që është lagjja kryesore dhe qendra e fshatit, lagjja VAGALAT, lagjja DEDELEKAJ dhe lagjja BREG.

Familjet, fiset, apo, thënë më saktë, vëllazëritë që jetonin deri vonë e që, për fat të keq, sot kanë larguar, duke u shpërndarë gjindja gjithandej nëpër Shqipëri, por edhe nëpër Botë, janë këto: Në lagjen BREG: Dafajt, Jonuzajt, Priftajt. Në lagjen DEDELEKAJ janë: Bratajt, Cekajt, Dibrët, Dorrajt, Kaçajt, Tytajt. Në lagjen GROPË apo QENDËR, siç quhet ndryshe, jetonte pjesa më e madhe e Malëshovës-fshat. Aty ishin familjet: Barkaj, Bylaj, Çulaj, Dafaj, Denaj, Haxhiaj, Kanellari, Kapedanaj, Kelaj, Laskaj, Londaj, Mashaj, Mato, Mëskutaj, Mullari, Nanaj, Note, Peçaj, Premtaj, Priftaj, Teraj. Në lagjen VAGALAT jetonin vëllazëritë: Dhimulaj, Kasnecaj, Marveftaj, Memaj, Pucaj, Rrumbullaku, Zaharaj. Pak parë thashë ***për fat të keq***.

Nuk po them ***për fat të keq***, sepse janë shpërndarë njerëzit nëpër Atdhe e nëpër Botë, për të jetuar më mirë. Por po them: ***Është fatkeqësi që malëshovitët nuk e mirëmbajtën vendrrënjën e vet,*** *për të pasur ku të rikthehen herëpas'here dhe për t'i ruajtur vlerat arkitekturore dhe, përgjithësisht, vlerat kulturore të këtij vendi, të cilat nuk janë as të pakta, as të papërfillshme.* Kanë emigruar dikur korçarët, por Korçën e kanë rregulluar. S'e kanë lënë të shkatërrohet.

Disa nga emrat e vendevet

Sidomos te njerëzit e larguar, emrat e vendevet kanë një domethënie të veçantë. Ata lidhen me pamjet, me kujtimet, me ngjarjet. Edhe një gur, edhe një lis, edhe një brinjë mali, njeriut që është rritur aty, i kujton diçka. Ndërsa ata që nuk kanë lindur aty, thonë: ***Ky është vendi i të parëvet të mi***.

Në Malëshovë, si në vetë fshatin Malëshovë, ashtu edhe në kuptimin e saj të zgjëruar, krahinor, ka me qindra emra vendesh, të cilët, jo vetëm ndjellin kujtime të të gjithë "***zhanreve***", deri në shenjtëri, por i vlejnë në mënyrë të pazëvendësueshme, sidomos shkencës.

BRINJA E BARKOVET, afër Kruagjelit, na e konkretizon praninë Barkajvet në ato hapësira. ÇUKA, DRIZ'E BARKOS, vend diku midis Limarit dhe Peshtanit. DULAJT, toponim në Shesh të Madh, GROP' E ÇUKËS, GJONËZ (Gjonëz,-i, apo Gjonëzi-,u, sepse njihen në mitologjinë popullore dy zogj me emrat *Gjoni i Zi* dhe *Gjoni i Bardhë*?), HIJ'E MADHE, në Limar, KISH' E VJETËR, kishë shumë e lashtë, KRUAGJEL, një ndër monumentet impozantë të kulturës malëshovite, KISH' E KRISTOFORIT, KUQET, KULURICA, dikur lagje, LËM' I BRATIT, LUGU I THELLË, LEKOVA, vend ku Barkajt kishin pronat, MAJ' E MBREZHDANIT, MAJ' E ÇUKËS, MASHTËRRORI, vargmal, pjesë e Dhëmbelit, MERDANËT, METAKSAJA, një emërtim grek, i cili ka lidhje me mëndafshin (A prodhohej aty mëndafshi, a kish mëna aty, për të ushqyer krimbin e mëndafshit, apo ish aty ndonjë pikë ku tregtohej edhe mëndafshi?!) PRODANI, POXA (emërtim që vjen nga ***podëz,-a,*** dëshmi që bashkimi i tingujvet D dhe Z, kur bie Ë-ja, japin tingullin X), PONDIQI, QAF' E LLESHIT, (Kemi këtu antroponimin verior Llesh, i cili vjen nga Aleksandër. A ka vepruar po ky formim emrash të njerëzvet edhe në Jug, apo lidhet kjo qafë mali

me ndonjë Llesh të ardhur nga Veriu?), QESINEKU, RAVENIA, (vend i sheshtë në krye të Mashtërrorit, formë, e cila mund të ndihmojë për shpjegimin e apelativit sllavisht: ***ravnina***), RRUNGAJA, SJADUNI, SOGORA, SHESHI I KAPEDANIT, SHESHI I MALIT, SHËN MITRI, kishë, TREPETICA, TARTARI, VARREZAT, varre shumë të lashtë, VENJËZA, VALI, pjesë te Sheshi i Madh, XANA, vend te Shën Mitri, ZASTENI.

Ja dhe dy vargje nga Andon Rrumbullaku: "***Blegërojnë dhen e dhi/ Zastenin e kanë vërri***."

Në këto hapësira, midis këtij ambienti shpeshherë të ashpër, por gjithmonë të madhërishëm, lindi, u rrit dhe, po me këto hapësira e lidhi qenien dhe shpirtin e vet patrioti i madh, Apostol Barko-Malëshova. ***Atdheu fillon te pragu i shtëpisë***.

Të flasësh për emrat e vendevet në një libër biografik, është, në mos e pavend, të paktën, e çuditshme. Megjithatë, ne shqiptarëvet nuk na rrihet pa hyrë pak edhe në etimologji, madje edhe kur takohemi në rrugë.

Marrë në tërësi dhe shikuar në sipërfaqe, duket sikur krejt toponimia e Malëshovës, si dhe e shumë trevavet të tjera në Shqipërinë Jugore, është e përmbytur me fjalë sllave.

Mirëpo, analizat më të thelluara nuk çojnë në të njëjtët përfundime. Shtresat sllave, ashtu si dhe ato latine, greke, apo turko-arabe, në topnimi, u ngjajnë rrobavet që i veshin njerëzit. Mund të vësh në kokë një qylaf të kuq e të mos jesh turk. Mund të mbulohesh me ferexhe. Je myslimane, por s'është e thënë që të jesh arabe apo indoneziane. Mund të veshësh pantallona kauboj e të mos jesh amerikan. Mund të vësh sombrero në kokë e të mos jesh meksikan.

Emri MALËSHOVË vjen nga një lokativ i hershëm i arbërishtes: MALËSH, që tregon një vend, ndërsa prapashtesa sllave, e cila tregon pronësi, është krejt e kotë, gjë që çon në mendimin se atë prapashtesë e kanë përdorur banorë që nuk e njihnin gjuhën sllave. Të njëjtën dukuri e kemi në Kosovë me emrin MALISHEVË, veçse atje prapashtesa sllave nuk është –OV(Ë), por –EV(Ë). Formën e një lokativi, e kësaj rase vendore, me një prapashtesë tjetër, e kemi te emri i një qyteti, në Malin e Zi të sotmin: KOLLASHIN, emër i cili vjen nga KOLËSH me prapashtesën –IN. Rrënja mund të jetë emër njeriu, Kolë, por mund edhe të mos jetë. Ndërkaq,

po lokativin, rasën vendore të hershme të gjuhës arbërishte, pa kurrfarë prapashtese, e gjejmë në Kukës, në emrin e fshatit KOLËSH, e gjejmë në MARTANESH, që vjen nga MARTINËSH, si dhe në emrin e fshatit VALËSH në Shpat të Elbasanit.

Pra, rrënja e emrit MAL/ËSH/OV/Ë është MAL. Asaj rrënje i është prapashtuar, tashmë në rolin fjalëformues, mbaresa rasore –ËSH. Më vonë, nën ndikimin e pushtuesvet sllavo-bullgarë, po më shumë nën ndikimin e Patriarkanës së Ohrit, e cila i përdorte kundërshtitë tona ndaj Kishës Ortodokse Greke, për t'u infiltruar me influencën e vet midis arbërvet, iu ndajshtua emrit MALËSH,-I, edhe prapashtesa sllave –OV. Por nuk ngeli me kaq. Vendësit arbër ia shtuan këtij emri vendi edhe prapashtesën femërorizuese –Ë. Nuk del e qartë përse ky emër vendi, që normalisht duhej të ishte emër mashkullor, kaloi në gjininë femërore.

Etimologët sllavë, e pas tyre edhe të tjerë, e nxjerrin këtë toponim nga antroponimi MALISHA, vogëlush, gjë që nuk është e vërtetueshme dhe prandaj mbetet përgjithnjë në fazë hamendjeje.

Te oronimi DHËMBEL shohim qartë rrënjën DHËMB, sigurisht, për shkak të konfiguracionit, dhe prapashtesën –ËL, të shndërruar në –EL, për shkak të zhvendosjes së theksit. Në Shestan kemi gjithkështu një oronim, emërmal, me rrënjën DHAMB, veçse atje prapashtesa nuk është –ËL (-EL), por –ËZ, pra, thuhet: DHAMZ,-I.

Për emrin MBREZHDAN, prapë është shprehur mendimi se është me prejardhje sllave. Kanë thënë se –ZHD është një prapashtesë sllavojugore lindore, pra, bullgare, e po kështu edhe prapashtesa –AN. As njëra, as tjetra nuk janë sllave. Prapashtesa –ZHD vjen e zëshmuar nga forma –SHT, e cila ka ardhur prej ilirishtes –ST. Krahaso: TERGESTE, Trieshte e sotme, emër që ka ekzistuar shekuj para ardhjes së sllavëvet. Edhe –AN është një prapashtesë shumë e hershme dhe duket se ka lidhje me emrin, dmth me apelativin ANË, vend, sepse i jep fjalës kuptim vendi. Kështu, MBREZHDAN vjen nga BRESHTË, bredhishtë, pyll bredhash, ndërsa zëshmimi ka të ngjarë të ketë ndodhur nën ndikimin e parashtesës tingëlluese M-.

Për LIMARIN e kemi vështirë të japim ndonjë mendim të qëndrueshëm. Fakti që theksi bie te I-ja e jo te A-ja, ndryshe nga GUSMAR, PICAR, PSAR, PENTAR, SKRAPAR, VASJAR etj, shtron pyetjen: Këtu, te LIMAR, a është –AR prapashtesë? Nëse nuk është –AR prapashtesë, atëherë kuptohet që LIM- nuk mund të merret si rrënjë. Por edhe në e marrshim pjesën LIM- si rrënjë, prapë na dalin paqartësi. Në latinisht forma LIM (limus) ka nja 3 kuptime: Si pranemër, mban kuptimin: ***i shtrembët, i vëngërt***, si emër, është lloj përparseje stolusur me gurë të çmuar. Nëse aty diku, jo larg Kalasë, ka pasur ndonjë faltore antike, mund edhe ta lidhnim me një të tillë përparëse, sepse pikërisht një e tillë përparëse përdorej, kur u blatoheshin flitë perendivet. Por LIMUS në latinisht ka edhe kuptimin e LYMIT, ***rërë e përzier me drurë të thërrmuar e me gjethe në kalbëzim e sipër***. Nuk do harruar edhe që, në krahinën e Matit, ka një folje ME LMUE, me ikë përpara, me u largue. Në Sicili jeton një popullsi e vjetër, e ardhur nga Azia e Vogël dhe quhet popullsi ELIME. Pra, ELIMËT janë popullsi e ikur, popullsi, e cila KA LMUAR. Deri këtu mund të vimë. Më tutje nuk mund të shkojmë, me kaq njohuri.

Për LESKAJ, na vjen prapë në shteg një fjalë sllave, LESK, që do të thotë ***lajthi.*** Mirëpo, sa herë që hasim në fjalë sllave, do mbajtur parasysh që pellazgo-iliro-arbro-shqiptarët kanë qenë këtu e pakta 25 shekuj para sllavëvet. Kur kanë ardhur sllavët në Gadishullin e Ilirikut, iliro-arbërit kishin 7 shekuj krishtërim. Në 3 shekujt e parë, sllavët nuk na dhanë kulturë, por morën kulturë prej nesh. Vetëm mbasi u pajisën me shkrim dhe mbasi krijuan shtetet e vet, ata filluan të na japin elmentë të kulturës së tyre. Në të vërtetë, në shumicën e rastevet, ata na rikthyen shumëçka nga ato që dikur na i kishin marrë. Kështu, forma LESK vërtet mund të jetë marrë prej sllavishtes, por, kur të heqim prapashtesën –K dhe rrënjën LES ta krahasojmë me LAJTHI, na del që LES të ketë dalë prej një *LETH, sepse fonetikisht TH-ja nuk mund të dalë nga S-ja. E kundërta ndodh thuajse rëndom: THIKË-SIKA (dokumentuar që në shekullin IV të erës sonë), THI-SVINJA, ME THITHË-SISATI. Në gjuhët sllave ka me mijëra iliro-albanizma. Prandaj, nëse themi që emri i fshatit LESKAJ lidhet me emrin LESK, ***lajthi***, aty, me siguri, kemi të bëjmë me dukurinë e rimarrjes, pra, të rikthimit të një fjale te gjuha e origjinës, në një formë tashmë të ndryshuar.

GRABOVA ka prapashtesën sllave –OV dhe prapashtesën femërorizuese shqipe –Ë. Rrënja GRAB, në sllavishtet ka kuptimin: shkozë, por nuk kuptohet kombinimi i saj me një prapashtesë përkatësie –OV. Veç kësaj, emri GRAB ka shkuar në sllavisht prej latinishtes CARPINUS (karpinus, shkozë), me metatezë shoqëruar me zëshmim tingujsh: KARP-KRAP (GRAB). Mirëpo, rrënjën e toponimit GRABOVË mund ta kërkojmë edhe te folja ME GRABITË. Në një të tillë rast, duhet të dimë që sllavishtet e kanë huazuar foljen GRABITI prej iliro-arbërishtes. Krahaso: KËRRABË-*ME KËRRABITË-ME GRABITË.

Po të ecet në këtë rrugë, do të mund të shkohej tepër larg, duke shtuar këtu, pa vend, numrin e faqevet. Toponimia e Malëshovës është një thesar i madh historiko-kulturor, ashtu siç është i gjithë trualli i Shqipërisë, i mbushur me frymë e me gjurmë jete shekull pas shekulli. Ndaj edhe e donin kaq shumë këtë vend njerëz si Apostol Barko-Malëshova.

Pronat e Barkajvet në Malëshovë

Familja BARKAJ, për nga pasuria, do llogaritur si një familje e mesme. Madje, duke filluar nga Kiçua, i jati i Apostolit, i cili ishte një njeri i sëmurë, familja e Barkajvet ndoshta bie diç më poshtë se të mesmet, sado që, në të gjitha kohët, duke qenë një "racë" vitale, ajo u mundua ta rivendosë pasurinë dhe ta ruajë krenarinë e së dikurshmes shtëpi e parë, siç mendohet se ka qenë para se të shpërngulej nga Hormova.

Pronat e BARKAJVET në Malëshovë, pas vdekjes së Apostolit, ishin këto: 2 shtëpi, e Lukanit dhe e Skënderit, kopshtet rreth shtëpivet, vendstrehimet për bagëtitë, kasollet për barin dhe zahirenë e bagëtivet, lëmi, 2 oborret, shtëpia e Peço Haxhiut, me gjithë kopshtinj e oborre, që Llukani ia pat blerë Peços së voni. (Peço Haxhiu ka qenë kushëri I Apostolit, por me pranemër të ndryshuar.)

Ishin pastaj: VRESHTI, dy rreshta me hardhi, TARTARI, tokë me tre vreshta, pemë, lisa etj, LEKOVA, toka dhe kullota, SHESHI I MALIT, tokë dhe kullota, VALI, tokë, METAKSAJA, tokë dhe shumë livadhe e kullotë, AR' E PEÇOS, tokë që më parë ishte e Peço Haxhiut, BRINJA, pyllnajë dhe kullotë afër Kruagjelit.

Toka të BARKAJVET kanë qenë edhe KULURICAT, por ato i pat shitur Kiçua, për arsye se ishte shëndetlig dhe nuk mund t'i punonte. Po kështu edhe SELISHTAT, që ishin toka afër shtëpivet.

Nga gjëtë e gjalla që mbante familja BARKA, ishin: lopët, dy apo tri krerë, një kafhsë barre, mushkë apo gomar, dhen, deri në 15 kokë, një derr dhe pula. Mbanin edhe dy apo tri koshere me bletë.

E gjithë kjo, për të siguruar një bazë jetësore, por, siç edhe mund të shikohet, nuk ishte as përafërsisht e mjaftueshme. Për këtë arsye, familja e BARKAJVET, ashtu si shumica e familjevet të Malëshovës, ka ushtruar edhe një profesion, një zeje, një zanat, me anë të të cilit, në të vërtetë, sigurohej pjesa më e madhe e të ardhuravet. **BARKAJT janë marrë tradicionalisht me zdrukthtari**. Kanë qenë marangozë, që kanë punuar nëpër fshatra të ndryshëm, kudo që gjenin punë: Në Përmet, në Tepelenë, Berat, Skrapar, madje deri në Mallakastër e Fier, apo në krahun tjetër, në Leskovik e Kolonjë.

Kjo ka bërë që edhe horizonti i tyre kulturor të jetë më i hapur, më i zgjëruar, se sa po të jetonin të mbyllur brenda një të vetmit fshat, apo, edhe më keq, brenda një prone familjare, egoiste dhe tepër të ngushtë. Apostol Barko-Malëshova e pat zgjeruar dhe e pat pasuruar edhe më shumë horizontin e vet, duke shkuar në mërgim. Duke shkuar atje, por edhe duke u kthyer. Duke mos e harruar. Përkundrazi, duke punuar dhe duke u shkrirë për vendin, të cilit i takonte.

Disa nga veçantitë e krahinës së Malëshovës

Secila krahinë ka gjërat e veta të veçanta, për të cilat, banorin e saj, kur është larg, e merr malli. Të flet për DHËMBELIN me pasion e me frymëzim. Për format e tija të bukura, për majat e rrumbullakësuara, për frymëzimin që ndjen, kur ngjitet në ato maja. Të flet për LEKOVËN, për barërat e saj karakteristikë. Në sllavisht, LEK do të thotë ilaç. Mos e ka marrë këtë emër për shkak të bimëvet mjekuese? ÇAJI, i cili rritet jo vetëm në Malëshovë, por në krejt atë malësi, i njohur si një ndër çajrat më të mirë të Shqipërisë. RIGONI është një tjetër bimë aromatike mbresëlënëse, e përdorshme në ushqime e gjellëra të ndryshme. E gjithë treva e Malëshovës është e mbushur, e mbuluar, e zbukuruar, me një lloj shumë cilësor të SHETREBELIT.

Prej drurëvet, gjithandej ka pasur DËLLINJA dhe KREKËZA, por krekëzat tashmë janë rralluar shumë. Lart te Kalaja ka pyje të bukur bredhi.

Kush shkon në Malëshovë, nuk mund të mos habitet e njëkohësisht të lemeriset, të tromakset nga të quajturat HINGAT E MALËSHOVËS. Kur e pyet malëshovitin: "***Ç'janë këto HINGAT***?", ai të përgjigjet: "***Janë do handakoma të thella, të krijuara nga rrëshqitjet e dheravet.***" Janë gjithsej nja 3 a 4, humnera të frikshme, që shkojnë e përfundojnë në Lumin e Zagorisë. Thellësia e tyre mund të arrijë deri në 100 metra. Që këto HINGA janë një krijesë e jashtzakonshme e natyrës, nuk ka dyshim. Por a mund të quhen MONUMENTE TË NATYRËS?!

Nga MONUMENTET E KULTURËS, e para që duhet përmendur, është KALAJA E LIMARIT. Është kështjellë e kohës ilire. Në Mesjetë ka qenë fortesë e rëndësishme, deri sa, siç shkruan studiuesi i shquar përmetar, Stilian Adhami, kanë ardhur sllavët dhe e kanë shkatërruar, duke asgjësuar ose dëbuar prej andej të gjithë banorët e krahinës. Përtej Kalasë gjendet një URË E VJETËR ME HARK, e cila ka shërbyer për të kaluar përtej Lumit të Zagorisë. Monumente të rëndësishëm të kulturës janë KISHAT. Kështu, janë ose kanë qenë, por që koha i ka shndërruar në rrënoja: KISHA E SHËN THANASIT, në lagjen Gropë, mbuluar me rrasa. Ka pasur afreske dhe zbukurime të tjerë. Ka pasur edhe varrezën pranë. KISHA E SHËN KRISTOFORIT, sipër të tri lagjeve, në rrafshin e Ravenisë. Edhe kjo e mbuluar me rrasa. KISHA E SHËNKOLLIT, në fund të Vagalatit. KISHA E SHËN MITRIT, në fund të Xanës, më afër me Limarin. Ka vetëm muret. KISHA E SHËN TODHRIT, në majë të Dhëmbelit, afër Nemërçkës. Në Malëshovë ka edhe një VARREZË SHUMË TË VJETËR, por që nuk është ruajtur mirë. KONDIZMAT janë një relike e moçme e krishtërimit, ruajtur deri në ditët tona, në disa vende, pranë rrugëvet që hynin në Malëshovë, gjegjësisht, që dilnin nga Malëshova. Të rregulluara bukur, me çatiza prej rrasash, me kamare ku ndizeshin qirinjtë, ato ngjallnin te kalimtarët ndjenjën e misterit dhe të shenjtërisë së vendit ku ndodheshin. Njëra KONDIZMË ishte afër Kishës së Shënkollit, në rrugën që shkonte nga Kulurica për në Vagalat. Një tjetër qe në Raveni, te rruga që vinte nga Deshnica e që shkonte në Lug të Thellë për në Këlcyrë dhe, një e tretë, pranë rrugës nga Dedelekaj dhe Limari për në Këlcyrë.

MONUMENTE të rëndësishëm KULTURE, në krejt krahinën e Malëshovës, kanë qenë, pa dyshim, shtëpitë tepër karakteristike. Një shumicë e tyre ishin dykatëshe, por kish shumë edhe njëkatëshe. Që të gjitha ishin **të mbuluara me rrasa**. Asnjë me tjegulla. Për të përshkruar konstruktin arkitekturor të shtëpivet të Malëshovës, natyrisht që do të duhej monografi e veçantë, por kërkesa kryesore do të ishte kjo: Malëshovitët e shpërngulur, kushdo që ka sado pak mundësi financiare, duhet të shkojnë në vendrrënjën e tyre dhe t'i restaurojnë shtëpitë e të parevet të vet. Po përmendim vetëm disa prej atyre që bënin shenjë midis tjeravet: Shtëpia e Kolo Haxhiut (Barkaj), shtëpia e Nine Nanajt, sot gërmadhë, shtëpia e Petro Tytos, shtëpitë e Laskajvet, e Sotir Laskos, e Vangjel Laskos.

LËMENJTË janë një tjetër element shumë mbresëlënës i KULTURES së Malëshovës, si kudo në trevat tona rurale. Lëmi i Leskaj, shtruar me rrasa, Lëmi i Brataj e shumë të tjerë.

Elementë kulture, prapë shumë tërheqës, sidomos në lagjen Gropë, kanë qenë edhe OBJEKTET E QYTETARISË. Lagjja Gropë ishte një qytezë e mirëfilltë, me duqane, me punëtori shërbimesh, me rrugë të shtruara dhe madje të emërtuara, si në qytet. Psh. ***Rruga "Skënderbe"***.

Disa nga thesarët e Malëshovës

Midis vleravet të veta, të veçanta historiko-kulturore, në malëshovë dallohen disa të atilla vlera që, me plot të drejtë, mund të quhen thesare.

1.Thesari i parë është gjuha shqipe që e ka përdorur kjo krahinë ndër breza të pafund. E folura e Malëshovës është një e atillë e folur , së cilës, në krahasim me standardin zyrtar, që u pa e arsyeshme, në vitet 1968-1972, të përgjithësohet si gjuhë e gjithë shqiptarëvet, mund t'i heqësh fare pak gjëra. Të tilla janë në përgjithësi të folurat e Përmetit, por Malëshova ka në këtë aspekt peshën e vet të rëndësishme. Se si është arritur një përsosuri e atillë fonetiko-leksiko-gramatikore në atë të folur tonën malore, mbetet për t'u zbuluar. Duhet të jetë doemos një tipar ihershëm i arbërishte mesjetare, i cili vihet re edhe ndër arvanitet e Greqisë. Zanoret, bshakëtingëlloret, lakimet, zgjedhimet, ndërtimi I fjalivet, të gjitha janë në një nivel të pranueshëm ose lehtësisht të korrigjueshëm për një gjuhë

kombëtare. Tipare të tillë, shumë të rëndësishëm për historinë e gjuhës shqipe, hasen edhe në trevat tona veriore, nëpër malësitë shqiptare, si në Rugovë, në Vuthaj, në Shestan, në Hot, në Drenicë e gjetkë.

2.Thesari i dytë është krijimtaria gojore. Malëshova ka një krijimtari gojore popullore, e cila, si nga cilësia, ashtu edhe nga shtrirja dhe zhanret, qëndron në të njëjtin rrafsh me krijimtarinë gojore të disa prej majavet të folklorit tone. Thëniet e urta malëshovite zënë kryet e filozofisë popullore të vetë trevës ku përdoren, por edhe të ardhura nga treva të tjera e të ruajtura aty. Malëshova ka këngë të panumërta. Kur ke përpara krijime të zhanrit të këngëvet historike, fitohet përshtypja sikur asnjë ngjarje , qoftë e madhe, qoftë e vogël, nuk është lënë pa u future në vargje. Këngët e dashurisë, të trevës së Malëshovës, janë sat ë shumta, aq edhe të bukura, me figura nga më të mrekullueshmet. Malëshova ka këngë mërgimi nga më prekëset. Këngët e dasmës janë të atilla që të mbushet mendja se pa to as që mund të bëhet dasmë në Malëshovë. Malëshova ka këngë humori shumë pikante. Proza popullore malëshovite është shumë pasur, veçanërisht zhanri i anekdotavet humoristike. Gjëegjëzat dhe vargjet që shoqërojnë lodrat e fëmijëvet, madje edhe lojërat teatrore të të rriturvet, janë përsëri të shumta, por edhe cilësore, nga më të bukurat.

3.melodité polifonike janë mjaft të ngjashmeme këngën polifonike labe, por kanë edhe dallime. Janë, tashmë dihet, pjesë e thesarit botëror, por, natyrisht, para se të jenë thesar botëror, ato janë thesar i mbarë kombit tone. Kush i ka dëgjuar, qoftë edhe një here, këngët e Malëshovës, qoftë të burravet të moshuar, qoftë të gravet apo vajzavet, atë e merr malli t'i dëgjojë përsëri. Malëshovitët janë mjeshtër në të kënduar. Ata i përjetojnë thellë në shpirt çdo varg e çdo tingull dhe kjo shihet edhe në fytyrat e në sytë e tyre gjatë gjithë inerpretimit.

4.Thesar tjetër I trevës së Malëshovës, janë veshjet e gravet dhe të vajzavet. Kuptohet, ato tradicionalet. Me atë veshje, të gjatë e të derdhur pas trupit, femra malëshovitem ngjan me një princeshë. Mendimi ynë është, që ajo veshje, bashkë me variantet e Pogonit, Leskovikut apo Kolonjës, ka mbërritur në ditët tona drejtpërsëdrejti prej kohës së Molosisë. Dhe është e çuditshme se si, në atë krahinë ku nuk sigurohej buka e vitit, çdo grua e kish të paktën 1 veshje të tillë

tradicionale: cohë krejt e qëndisur dhe e shoqëruar me një grusht jot ë vogël stolish prej floriri.

Pasuri të veçanta kulturo-ekonomike

Malëshova, duke qenë vend mal, ka qenë pa resurse të bollshëm për mirëqenie, aq sa, kur shkon atje ndonjë që ka jetuar në vende me më shumë bollëk, thotë: ***Ç'i ka detyruar këta njerëz të ndërtojnë shtëpi e të rrojnë midis këtyre humbëtirave?!*** Megjithatë, ja që kanë jetuar njerëzit edhe aty! Madje, e kanë dashur atë vend si asnjë vend tjetër në botë dhe, kur kanë shkuar diku larg, qoftë edhe në Amerikë, i ka marrë malli aq shumë për vendrrënjën e vet, sa nuk ua ka mbushur syrin asnjë lloj pasurie.

Duke qenë në të tillë kushte, duke mos dashur të largohen prej atij vendi e, megjithatë, duke mos pranuar të rrojnë në varfëri, malëshovitët, me sa duket, me shekuj, kanë ushtruar dy profesione të rëndësishëm: **Drupunimin** dhe **bakërpunimin**. Të gjithë burrat, ose thuajse të gjithë burrat, duke ndjekur edhe traditën e vet familjare, kanë qenë: ose zdrukthtarë, ose bakërpunues apo siç quheshin ndryshe, ***kallajxh***i. Ata dilnin nga fshatrat e vet dhe merrnin krahinat rretherrotull: Gjirokastër, Tepelenë, Mallakastër, Berat, Skrapar, Shqeri, Frashër, Leskovik, Kolonjë, Kostur, Konicë e deri në Janinë. Shkonin, punonin andej, bënin një dorë para, ktheheshin në shtëpi, e furnizonin familjen me ushqime e ç'duhej tjetër, shmalleshin dhe shkonin prapë. Në stinët e punëvet, ndaleshin, sa t'i kryenin ato pak punë dhe iknin sërish secili pas zanatit të vet.

Krahina e Malëshovës, veçanërisht Limari dhe Leskaj, kanë pasur edhe një tjetër "***profesio***n", për të jetuar. Por ky nuk ishte për t'u lëvduar. Ishte "***profesioni***" i dervishit. Së këndejmi ka mbetur edhe shprehja: ***Dervish Malëshove***. Nuk ka qenë ndonjë zgjedhje fetare. Ka qenë më shumë prirje dembelësh. Jetesa duhej përballuar, por, individë të veçantë, për punë, si marrangoz a si bakërpunues, nuk ia thoshin dot dhe i kushtoheshin "***zanatit***" të dervishit. Dikur, siç duket, u bënë shumë dhe u doli nami si ***dervishë Malëshove***. Por duhet vënë në dukje që, ky lloj "***zanat***i", sidoqoftë, nuk mund të barazohej me "***zanatin***" e hajdutit, siç e kishin

disa nga krahinat tona. Malëshovitët, siç thuhet, nuk i kanë pasur traditë vjedhjen apo grabitjen dhe kjo është për t'u vlerësduar.

Një veçori kulturore nga më interesantet ka qenë në Malëshovë **zhargoni gjuhësor i dogançes**. Nuk është vetëm veçori kulturore, por është edhe pasuri e llojit të veçantë. Është një gjuhë artificiale, e krijuar, siç duket, pikërisht sepse burrat e kësaj krahine e kalonin shumicën e jetës nëpër familje të huaja, atje ku kishin edhe punën. Duke bujtur kështu herë në një familje, herë në një tjetër, atyre u kish lindur nevoja për të komunikuar njëri me tjetrin me një mënyrë që të zotët e shtëpisë nuk do ta kuptonin. Jo se kishin sekrete të mëdhenj, por, sidoqoftë, dy fjalë, ndonjë urdhër a ndonjë vërejtje, do të duhej t'ia thoshin njëri-tjetrit. Nuk kanë zgjedhur as greqishten, as turqishten, por kanë sajuar një zhargon të vetin. Sigurisht, kjo nuk është ndonjë gjuhë me morfologji dhe me sintaksë të zhvilluar. Ka një fjalor të vetin mjaft të pasur dhe një numër fjalishë, aq sa u duheshin njerëzvet për t'u marrë vesh. Është e njëjta metodë, siç është përdorur psh, te esperantoja, por jo produkt shkencëtarësh. Do të ishte punë shumë e mirë, që dikush prej vendësvet të merrte përsipër e t'i mblidhte të gjitha fjalët dhe shprehjet e dogançes dhe t'i botonte ato në një libër më vete. Është një pasuri, së cilës, me kalimin e kohës, kur nuk do ta përdorë më askush, do t'i rritej vlera aq shumë sa njerëzvet do t'u vinte keq nëse nuk do ta kishin të botuar, dmth, të ruajtur atë gjuhë, të themi, endemike.

GJENEALOGJI E PJESSHME E VËLLAZËRISË BARKAJ

Sipas shtjellimit të Leonidhë Llukan Barkos, nipit të Apostol Barko-Malëshovës, pas shkatërrimit të vendrrënjës së tyre të hershme, Hormovës, dhe pas masaktrimit apo shpërndarjes së më shumë se pesë mijë banorëvet të saj, nga ana e Alipashë Tepelenës, familja e madhe e Barkajvet është ndarë në 3 pjesë. Njëra pjesë, e mbetur gjallë, është vendosur diku në fshatrat e Tepelenës, një pjesë ka shkuar në Dropull, ndësa e treta pjesë e Barkajvet është ngjitur në Malëshovë.

Kryefamiljari i kësaj pjese të familjes Barkaj mbahet mend me emrin ***PROTOPAPAI*** Por nuk është e qartë, a ka qenë ky emri i tij, apo ka kuptimin: ***babai i parë***,

kryefamiljari i parë. Pjesa PAPA mund të ketë edhe domethënien PRIFT. Sidoqoftë, prej tij, prej **PROTOPAPAIT**, thuhet se e kanë prejardhjen të gjithë Barkajt e sotëm të Malëshovës.

Leonidhë Llukan Barko a Barkaj tregon një ngjarje lidhur me Protopapanë. Kur ka ardhur nga Hormova, bashkë me 3 vëllezër, ka qenë në moshë mesatare. Nën drejtimin e tij janë ndërtuar disa kisha, të cilavet u kanë vënë emrat e kishavet të Hormovës. Me pjesën myslimane të Leskajt e të Limarit, të krishterët e Malëshovës shkonin mirë. (Që të krishterët hormovitë kishin marrëdhënie miqësie me shumë myslimanë të krahinavet rretherrotull e vërteton edhe murgu sërb, Dositej Obradoviqi, i cili për Hormovën ka shkruar kujtime shumë të vlefshëm.) Protopapai i Barkajvet qe vëllamëruar me Meçe Demirin, një bashkëkrahinas trim, nga fshati Leskaj. Kjo shkuarje mirë midis dy konfesioneve, ky vëllamërim midis shqiptarëvet të krishterë dhe myslimanë, nuk u përshtatej as pushtetarëvet osmanë, as kishës ortodokse greke. Kështu, dhespoti grek, apo progrek, kish paguar disa myslimanë që ta vrisnin Protopapanë e Barkajvet dhe ashtu të provokohej armiqësia midis banorëvet të krahinës.

Është zgjedhur festa e përvitshme që organizohej te Kisha e Shëngjergjit, e cila ndodhej në Leskaj. Aty, në ditën e asaj feste, siç duket, në Ditën e Shëngjergjit, organizoheshin edhe lojëra sportive, traditë kjo e mbetur që nga lojërat olimpike të Antikitetit. Bëhet festa, zhvillohen lojërat dhe, në kthim, te vendi i quajtur Pylli i Shënkollit, Protopapain e Barkajvet e qëllojnë dhe e vrasin.

Para se ta varrosnin, malëshovitët e krishterë, banorët e lagjes Gropë dhe të lagjevet të tjera, betohen mbi trupin e të vrarit se do të shkonin në Leskaj dhe s'do të linin mashkull të gjallë. Mirëpo, gjatë varrimit, vjen aty Meçe Demiri, vëllami i Protopapait. 300 pushkë i drejtohen për ta vrarë, por ndërhyjnë më të moshuarit dhe vrasja nuk bëhet. Meçe Demiri u kërkon afat malëshovitëvet të krishterë: "***Nëse nuk ia marr gjakun brenda vitit, atëherë të më vrisni mua***." Në krye të 6 muajvet, Meçe Demiri i vret, për gjakmarrje, të tre vrasësit e vëllamit të vet. Në këtë mënyrë, vëllamëria mbetet, qëllimi i kishës greke dhe i pushtetarëvet osmanë nuk realizohet.

Nëse Protopapai ka ardhur i rritur nga Hormova, del që kjo ngjarje të ketë ndodhur rreth vitevet 1800 dhe i bie që Kiçoja, i jati i Apostol Barko-Malëshovës, lindur në mesin e sh XIX, ta ketë pasur Protopapanë gjysh të të jatit, pra, gjysh të rendit të dytë, që zakonisht quhet stërgjysh. Në këtë mënyrë, mungojnë dy emra në rendin gjenealogjik të Barkajvet të Malëshovës: I jati i Kiços dhe gjyshi i Kiços.

Kjo do të ishte gjenealogjia e pjesshme e kësaj dege të Barkajvet, që thuhet se është vendosur në Malëshovë pas prishjes tragjike të Hormovës. Studiuesvet të ardhshëm do t'u mbetej detyrë, jo vetëm të zgjëronin e saktësonin këtë gjenealogji, por të merrnin vesh edhe ç'është bërë më konkretisht me dy degët e tjera të Barkajvet, pas largimit nga Hormova. Thuhet që në Hormovë ka pasur deri vonë dy toponime: ***Portë e Barkajvet*** dhe ***Kambanë e Barkajvet***. Edhe kjo mbetet për t'u hulumtuar.

FËMIJËRIA DHE RINIA E HERSHME E APOSTOLIT

(1874 - 1896)

I jati, siç thamë, ishte Kiçoja (Kristoja), e ëma qe Zoica, bijë nga fisi Çemi i fshatit Limar. Apostoli qe djalë i vetëm. Lindi më 10 shgtator 1874. Pat edhe një motër, Tilën (Sotirën).

Për shkak se Kiçoja ishte shëndetlig, fëmijëria e Apostolit qe e vështirë. Familja nuk kish kurrfarë të ardhurash. Kiçoja u detyrua të shesë një pjesë të tokavet, për t'u ushqyer.

Sapo u bë i zoti për të punuar diçka, fill mbasi mbaroi një shkollë fillore të fshatit, ku mësimi jepej në gjuhën greke, Apostoli iu vu profesionit të zdrukthtarit. Dilte nëpër fshatra, bashkë me ndonjë mjeshtër të rritur dhe punonte, fitonte, e njëkohësisht e përvetësonte zanatin.

Pano Rrumbullaku shkruan te gazeta "***Luftëtari***" më 29 janar 1978: "***Lindi dhe u rrit në një familje shumë të varfër fshatare dhe, që në vogëli, punoi si marangoz duke bredhur fshat më fshat, ku vuri re nga afër gjendjen e rëndë e të mjeruar***

ekonomike dhe shtypjen e shfrytëzimin e dyfishtë që i bëhej popullit sa nga bejlerët e arhondët vendës, aq edhe nga pushtuesit."

Në këtë kohë pati në jetën e Apostolit edhe një ngjarje, nga ato që, në jetën e shqiptarëvet, mund të quhen sa interesante, aq edhe të çuditshme. E martuan që në moshën 12-vjeçe. Më mirë të thuhet: I sollën në shtëpi, me synimin që, sapo të rriteshin, t'i martonin, një vajzë, Tilën (Sotirën) nga fisi i Meshinajvet.

Nuk ishte martesë. Ishte marrje në shtëpinë e burrit të ardhshëm të një nuseje të ardhshme. Kudo ndodh që dy fëmijë të rriten në të njëjtin konvikt, në të njëjtën shkollë, në të njëjtën lagje, dhe pastaj të martohen. Këta u rritën në të njëjtën familje, të paracaktuar për t'u martuar.

Tila, e motra, dhe Tila, e shoqja, të cilat rrojtën deri vonë, e ilustronin këtë lloj martese me një kallëzim, si punë anekdote. Kiçoja, sado i sëmurë, dhe Zoica, patën grumbulluar në oborr gurë, rrasa dhe qereste, lëndë për të ndërtuar një shtëpi të re. Apostoli dhe e shoqja, Tila e Meshinajvet, vinin sipër gurëvet një nga drurët e qerestesë, hipnin njëri në një krah e tjeri në krahun tejtër dhe koloviteshin.

Vetëm mbasi i mbushën 17 vjetët, ndodhi martesa e tyre e vërtetë. Andon Zako-Çajupi, pikërisht të këtillë prototipe martesash ka përgjithësuar në veprën e tij të pavdekshme "***14 vjeç dhëndër***". Apostoli, madje, nuk ish 14 vjeç. Ai ish 12 vjeç, kur e "***martoi***" familja.

Në vitin 1896, në moshën 22 vjeçe, kur tashmë ish me 1 fëmijë, Konstandinën, Apostoli mori rrugën e mërgimit, sepse, sado që të punonte nëpër fshatra, të ardhurat ishin aq të pakta, sa me to jeta nuk mund të përballohej. Shkoi në Bullgari.

NË KOLONINË SHQIPTARE TË SOFJES (1896-1903)

Shkoi në Bullgari dhe, puna e parë, përveç punës për t'u siguruar jetesën familjes dhe vetes, ishte të mësonte lexim dhe shkrim në gjuhën shqipe. Soqëria "***Dëshirë***", themeluar prej shqiptarëvet mërgimtarë në Sofje, këtë punë bënte: U mësonte bashkatdhetarëvet shkrim e lexim në gjuhën amëtare. Apostoli ish 22 vjeç.

Përballja me të vërtetën tepër të hidhur, tepër revoltuese, tepër pagjumëlënëse: ***Si ish e mundur që në Malëshovë të mos mund t'u mësohej fëmijëvet të lexonin e të shkruanin në gjuhën e të parëvet të vet e të lihej kjo punë për t'u kryer në Bullgari?!,*** duhet të ketë ndikuar te ai djalë i ri në mënyrë shumë tronditëse. Ai e donte familjen e vet. Për atë familje kish dalë rrugëvet. Por i donte, edhe fshatin ku kish lindur e ku ish rritur, edhe krahinën. Në përjetimin e një të atillë lufte brenda vetëvetes, ai, në ata vite, duhet të ketë konkluduar që **njeriut nuk i lejohet të presë sa të rregullohet për vete e pastaj, në i daltë koha, të përpiqet edhe për vendlindjen**. Alarmi që, jo vetëm si person e si familje, por edhe si krahinë e si atdhe, gjendja si mos më keq, duhet të kenë bërë që në vetëdijen e tij të zërë rrënjë edhe **ndjenja e sakrificës**. Ndjenjë që me kohë iu imponua si detyrë dhe që e shoqëroi gjatë gjithë jetës, deri në frymën e fundit. Frymë që e shtiu për të fundit herë në mushkëri, në rrethana më se tragjike, i rrëzuar e i përgajkur mbi kuvertën e një anijeje.

Ne nuk kemi dëshmi të shkruara mbi jetën dhe veprimtarinë e tij në shoqërinë atdhetare rilindëse "***Dëshirë***" dhe as mbi të mëvonshmet veprimtari të tijat, në Argjentinë e gjetkë. Kjo na ka shtyrë shpeshherë të mendojmë: Mos është më mirë të përpiqemi për të mbledhur më shumë të dhëna, pastaj ta shkruajmë këtë libër?! Por ngadhnjeu te ne filozofia e vetë Apostolit. Ajo që thamë pak më lart: **Më mirë t'i shkruajmë ato që dimë e t'u lëmë mundësi të tjerëvet për t'i plotësuar mangësitë tona, se sa të mos shkruajmë asgjë dhe t'u lëmë mundësi edhe të tjerëvet për të mos shkruar asgjë.**

Llukan Barkoja, djali i tij, i cili, edhe shpirtërisht, ka jetuar me të jatin më shumë se të gjithë të tjerët, na ka lënë një fletore 75-faqëshe mbi jetën dhe veprimtarinë e Apostol Barko-Malëshovës.

Për ata vite Llukani shkruan: "(Gjatë qëndrimit në Bullgari) ***Apostol Barko-Malëshova u forcua shumë si atdhetar e luftëtar i zjarrtë e i palodhur i gjuhës shqipe. Apostolin, shoqëria 'Dëshirë' në Sofje e ndihmoi shumë, se u brumos e u edukua me frymën e atdhedashurisë shqiptare"*** (LL.B.f.8) "***Sa herë që kthehej në shtëpi nga Bullgaria, Apostoli do të binte, sillte, me vete libra shqip, si Abetare, të cilat i lexonte me shokë e miq liridashës, i mësonte si të lexonin vetë***

Abetaren." (Ll.B.f.8) "***Ai ishte një atdhetar fisnik me ndjenja shqiptare dhe shumë i dashur me shokë dhe shumë i rreptë me armiq. Ai kudo propagandonte Shqipërinë dhe shqipen, pa u lodhur. Me dashurinë e tij të zjarrtë, i grumbullonte shokët dhe fshatarët për të lexuar e mësuar*** (shkrim në) ***gjuhën shqipe.***" (Ll.B.f.8) "***Librat që binte nga Bullgaria, ai i shpërndante falas nëpër fshatrat e Malëshovës, Leskaj e Limar, fshehur nga qeveria turke, se ishin të ndaluar. Po të kapeshe, vriteshe ose internoheshe. Po Apostoli nuk u treb nga kjo*** (rrethanë e rrëzikshme), ***sepse, nga shoqëria 'Dëshirë' ishte forcuar me ndjenja kombëtare për Shqipërinë dhe s'pyeste më për jetën e tij.***" (Ll.B.f.8-9) "(Njëherë) ***kur ia pa librat Kolo Haxhiu, një kushëri i tiji, u çudit dhe i tha: 'Po pse, more Apostol, merresh me këta libra? Ti e di se me këta libra gjen belanë dhe dënohesh me vdekje. Pse nuk rri urtë? Pse nuk shikon punën tënde, po merresh me*** (këto punë të rrëzikshme)?' ***Apostoli*** (iu kthye) ***Kolos: 'Mjaft fole, o Kolo! A nuk u lodhe? A nuk e di ti, more Kolo, se ne jemi shqiptarë e bij shqiptarësh?.. Këta libra që shikon ti, janë Abetare shqipe, të cilat unë e di që i ka ndaluar e dënuar Turqia. Sepse ajo ka frikë nga këta libra, sepse*** (këta libra) ***i mësojnë atdhetarët shqiptarë*** (për ta) ***sulmuar Turqinë e për të mos e lënë rehat, qoftë me pushkë, qoftë me penë.***'" (Ll.B.f.9) (Apostol Barkoja vazhdon këshillat me Kolo Haxhiun): "***Unë të këshilloj, Kolo, që edhe ti të mësosh*** (shkrim e këndim në) ***gjuhën shqipe, pa frikë, se*** (kjo gjuhë) ***është gjuha jonë, gjuha e baballarëvet tanë, dhe unë do të të ndihmoj që të bëhesh edhe ti një atdhetar shqiptar, si shokët e tjerë.***" (Ll.B.f.9-10)

Duke lexuar të këtillë informacione, njeriut nuk mund të mos i lindin një varg pyetjesh: Përse detyrohej Apostol Barkoja t'i mbushte mendjen kushëririt të vet, Kolo Haxhiut, se DUHEJ EDHE AI të mësonte shkrim e lexim në gjuhën shqipe? Pse, një greku, atje në Greqi, në Kohën e Pushtimit Osman, nuk kish nevojë askush t'ia mbushte mendjen se duhej të ishte i krishterë dhe se duhej të fliste, të shkruante etj, në gjuhën greke? Pse ai, greku, qoftë edhe tre herë më i prapambetur se Koloja i ynë, i dinte vetë këto gjëra dhe s'kish nevojë për kurrfarë propagande?! Pse Sërbi?! Pse malazezi?! Pse Bullgari?! Përgjigjja është kjo: Sepse këta **I KISHIN INSTITUCIONET NË GJUHËT E TYRE**! Kishin kishat e tyre në gjuhët e tyre! Ne jo! Ne nuk i kishim institucionet tanë kombëtarë dhe nuk i kemi as sot! E kishim

institucionin familjar, por nuk e kishim institucionin kombëtar! Sot i kemi institucionet shtetërorë dhe institucionet arsimorë, por institucion KOMBËTAR ende nuk kemi! Prandaj edhe sot, duhet të shkosh, si shoqatë apo si individ, e t'u mbushësh mendjen miliona shqiptarëvet, shpërndarë nëpër botë, se duhet t'u flasin shqip fëmijëvet në shtëpi, se duhet t'u mësojnë fëmijëvet, lexim e shkrim shqip dhe histori të shqiptarëvet, përndryshe, ata bëhen çfarë t'ua sjellë rasti: anglezë, francezë, arabë, turq, grekë, madje edhe malazezë, një komb që, për nga numri, s'është as sa gjysma e Tiranës. Është koha, pra, që edhe shqiptarët ta krijojnë **INSTITUCIONIN E VET KOMBËTAR**! Tani jo më një kishë gjithshqiptare, sepse është e pamundur, por një lloj tjetër organizmi të përbashkët, më modern se kishat apo xhamitë.

Xhako Llukani vazhdon: "***Kolua u bind dhe i mori një Abetare Apostolit. Me ndihmën e Apostolit Kolua mësoi të lexojë e të shkruajë vetë. Së fundi u ndie i kënaqur dhe e falenderoi Apostolin. Kështu u fut edhe ai në radhën e patriotëvet…*** (Sa herë që vinte puna, ai) ***i përkrahte Shqipërinë dhe shokët patriotë që luftonin për çështjen e Shqipërisë, të gjuhës shqipe e të tjera***." (Ll.B.f.10)

"***Në fshat, Apostoli, gjatë kësaj kohe, kishte një mbështetje të madhe, qysh në fillim, nga vëllazëria Laskaj: Llukani, Vangjeli e Stefani, dhe nga kushëriri i tyre Sotir Lasko. Edhe ata propagandonin dhe flisnin për gjuhën shqipe, për Shqipërinë… Me ndihmën e Apostolit në Malëshovë mësuan*** (këndim e shkrim në) ***gjuhën shqipe shumë veta, fshehur nga qeveria turke***. (Të gjithë ata u bënë atdhetarë të mirë.)" (Ll.B.f.10)

Sipas Llukan Barkos, mësuan këndim e shkrim në gjuhën shqipe nga Apostol Barko-Malëshova, këta malëshovitë: "***Atdhetarë të vjetër, Thoma Nano, Çoke Rrumbullaku, Naço Bylo, Vasil Peçi, Taqe Note, Kolo Haxhiu, Papa Jani Lasko, Xhelo Tyto, Vasil Masho, Gaqo Qorri, Vasil Note, Koço Jonuzi, Thanas Dafa, Polo Dibra; atdhetarë të rinj, Jano Keqi, Thimjo Nano, Naço Ceka, Niko Kaçi, Dhame Puci, Marko Puci, Stefan Nano, Vangjel Pilo Tyto, Kiço Dëna.***" (Ll.B.f.11)

Do të mjaftonte kjo e dhënë, që Apostol Barko-Malëshova të shpallej ***Mësues i Popullit***.

"(Pati edhe) ***nga Leskaj e Limari,*** (që mësuan këndim e shkrim prej Apostol Barkos dhe të gjithë ata) ***morën pjesë edhe në Revolucionin e Qershorit më 1924 kundra Ahmet Zogut. Këta atdhetarë e të tjerë… u bënë propagandistë të çështjes shqiptare***." (Ll.B.f.11)

"***Më 1903***," shkruan Llukan Barkoja, "***Apostoli u kthye njëherë e përgjithmonë nga Bullgaria dhe u nda nga Shoqëria 'Dëshirë', si dhe nga shkolla shqipe e Sofjes. Këtë radhë ai solli libra shqip më shumë, me qëllim që t'i shpërndante kudo në miq e në shokë.***" (Ll.B.f.12)

Më 1902-shin kish lindur Llukani e nja 4 vjet më vonë, siç duket, ka lindur edhe Dhimitraqi, djali që shkoi me të më 1925-n në Kubë dhe s'u muar vesh kurrë ç'u bë me të. Kështu, Apostoli e Sotira,Tila, të "***martua***r" qysh 12 vjeç, deri më 1906-n qenë bërë me tre fëmijë.

Për Sotirën, Tilën e Barkajvet, kësaj periudhe të jetës së saj, do t'i përshtateshin më së miri vargjet vuajtjerëndë, që femra shqiptare i ka përjetuar shekull pas shekulli:

"***Në mëngjes, nata pa sosë,***

Ç'bën, moj ti, atje përposhë?

Laj fustanen e tim zot,

Herë me ujë e herë me lot.

E mjera, s'e poqa dot,

Erdhi prëmë e iku sot!"

NË VENDLINDJE (1903-1906)

Vazhdojmë me shënimet e Llukan Barkos: "***Ia filloi punës si marangoz fshat më fshat, që, edhe të punonte, edhe të shpërndante Abetaret – zërin e Atdheut***." (Ll.B.f.12) Pano Rrumbullaku, në artikullin e tij , më 1978, shkruan: "***Apostoli i hyri rrugës së vështirë të luftës për shkrimin shqip e për shkollën shqipe, duke u bërë figurë e shquar dhe njeri shumë i dashur për të gjithë ata që bashkëpunuan me të***." (P.Rr.1978)

Mund ta përfytyrojmë një mjeshtër druri, i cili ua zbukuron jetën njerëzvet, duke u bërë dritare, orendi, tavane dhomash. Të zotët e shtëpivet kënaqen me punën e tij dhe nuk u dhimben paratë që i japin, pjesëtarët e familjevet ndjehen mirë, kur e shohin që shtëpia e tyre po plotësohet me gjëra që i kanë munguar, fëmijët e vështrojnë me kuriozitet, gjersa ai punon, dhe ëndërrojnë që të bëhen edhe ata mjeshtër si ai.

Në anë tjetër, Apostoli i percepton ata njerëz që e rrethojnë, shumë më ndryshe nga ç'do t'i perceptonte një marrangoz i zakonshëm. Ai dëshiron që atyre njerëzve jo vetëm t'u rregullohet e zbukurohet shtëpia, por edhe mendja. Xhako Llukani shkruan: "***Në çdo fshat që shkonte, e merrte përsipër që t'u mësonte fshatarëvet shkrim e këndim shqip. Po të qe nevoja, edhe natën***." (Ll.B.f.12)

Ne nuk e dimë sa i njihte ai shkaqet, pse territoret ku kanë jetuar ilirët janë zvogëluar kaq shumë. Nuk e dimë, a e dinte ai që Ishujt e Egjeut dhe Ishujt Dalmatinë kanë qenë dikur të banuar prej të parëvet tanë dhe që tash ata u takojnë popujvet të tjerë dhe, pse kish ndodhur kështu. Por e dimë që çastin, në të cilin jetonte, e kish kuptuar më shumë se kushdo tjetër rreth tij: Pa mësuar shkrim e këndim në gjuhën e vet, dhe pa e përdorur atë shkrim e këndim, ato shtëpi dhe ato orendi ai popull kot që i ndëtonte.

"***Kështu punonte Apostoli nëpër katundet***," shkruan Xhako Llukani. "***Punonte dhe u mësonte*** (njerëzvet) ***shkrim e këndim në gjuhën shqipe***." (Ll.B.f.12) Në qoftë se, deri sa ndodhej në Bullgari, bënte më shumë punën e një libraprurësi dhe librashpërndarësi, tani ai ishte shndërruar në një **MËSUES** të mirëfilltë. Apostol Barko Malëshova, pra, duhet konsideruar si njëri prej mësuesvet shqiptarë të asaj kohe, krahas me Papa Kriston, me Petro Ninin e me të tjerë. Është një mësues, i cili punonte në një mënyrë krejt origjinale, jo në lokale të caktuar për mësimdhënie, që quhen klasa, por nëpër familje. Kuptohet që, në ato dhoma, nuk mblidheshin vetëm kalamajtë apo të rriturit e një familjeje të vetme, por edhe fqinjë e kushërinj, kështu që, një dhomë e tillë s'ish tjetër veçse **KLASË MËSIMORE**. Kemi të bëjmë kështu me një përdorim modern të dhomës tradicionale shqiptare, përdorim, i cili, po të ish praktikuar në këtë mënyrë, në rrjedhë të sheklujvet, Kombi ynë sot kushedi në ç'maja të larta do të qëndronte.

"***Mësuan shumë veta, si në Mezhgoran, në Koshtan, në Krahës, në Toç e në të tjerë fshatra të Tepelenës***." (Ll.B.f.12) Kush të ketë punuar si mësues i gjuhës shqipe, para Apostol Barko-Malëshovës, në këtë rreth?! Historiku i arsimit i rrethit të Tepelenës duhet pa tjetër ta pasqyrojë dhe ta vlerësojë punën e këtij njeriu, si një **punë prej pionieri në fushën e arsimit**. Por jo vetëm në fushën arsimit. Rilindësit ishin të gjithanshëm dhe Apostoli ka qenë një rilindës nga më të kompletuarit. Puna e tij arsimore ishte njëkohësisht, edhe atdhetare, edhe politike. Kështu shkruan djali i tij Llukan Barkoja: "***Në Mezhgoran kishte një mbështetje kombëtare që e përkrahte Apostolin. Këta ishin: Beqir Mullai dhe Dervish Sami Mezhgorani, i cili kish shfaqur shumë dëshirë e dashuri për gjuhën shqipe***." (Ll.B.f.12) "(Me ndihmën e Apostolit) ***mësoi shkrim e këndim shqip pothuaj gjithë fisi*** (i Dervish Samiut), ***të gjithë burrat e Mullarajvet, si dhe fshatarë të tjerë mezhgoranas. Të lexuarit dhe të shkruarit, shumë vetë vazhdonin ta mësonin nga njëri-tjetri.***" (Ll.B.f.13) Qenka krijuar, pra, një bërthamë jo vetëm arsimore, por edhe patriotike në fshatin ku, papritur, **një marrangoz po bënte mrekullira**! Mbetet për të shpresuar që mezhgoranasit do t'ia ngrejnë një përmendore këtij veprimtari kaq të zellshëm dhe kaq produktiv në punët e tija. Unë do të isha i lumtur, në qoftë se ky libër do të ndihmojë sado pak për një vlerësim më të plotë të punës së këtij rilindësi kaq të madh dhe, fatkeqësisht, kaq të lënë nën hije.

Shohim tani punën e tij në Krahës të Tepelenës. Mua po më kujtohet tash një bisedë e shkurtër me patriotin e shquar Kalo Brahimin, në një stol lulishteje në Tepelenë. "***Çupën e kujt ke marrë, o bir?***" Më pyeti. "***Të Llukan Barkos.***" Iu përgjigja. Ai lëvizi nga vendi, më pa një copë herë dhe tha: "***Paske marrë mbesën e Apostol Barko-Malëshovës!.. Të rralë kanë qenë burrat si ai!"*** Në fund të bisedës, tek po largohesha, më zgjati dorën, pa u ngritur (se ishte shumë i plakur), dhe më tha: "***Haj, me një Kosovë të lirë, mor djalë!***"

Ja çfarë shkruan Xhako Llukani, i cili, në ata vite, e ka shoqëruar të jatin gjithandej: "***Në katundin Krahës të Tepelenës, Apostoli, duke punuar, u njoh me Kalo Brahimin, Dervish Mehdiun dhe të vëllezërit, Salon, Abedinin e të tjerë fshatarë nga Krahësi. Me ndihmën e Apostolit, ata mësuan shkrim e lexim shqip shumë mirë.***" (Ll.B.f.13)

"***Edhe në katundet Koshtan e Toç të Tepelenës, ku ishte duke punuar marangoz, Apostoli propagandonte për gjuhën shqipe. Por edhe populli interesohej dhe*** (njerëzit) ***e donin, sepse kishin shumë dëshirë që të mësonin shkrim e këndim në gjuhën*** (e vet)." (Ll.B.f.13)

Në të vërtetë, Llukani, në kohën kur ndodhnin këto ngjarje, nuk ka qenë më shumë se 4 vjeç. Por, mbas vitit 1920, kur Apostoli, i sapokthyer nga mërgimi i dytë dhe nga luftërat, doli përsëri nëpër fshatra, për të punuar si marangoz, e mori edhe Llukanin me vete dhe, me atë rast, ai mundi t'i dëgjojë prej gojës së të jatit e t'i njohë më mirë ngjarjet, për të cilat po flitet këtu. Cilësia që kish Apostoli për të komunikuar me njerëzit, duhet të ketë qenë nga më të rrallat. Aftësia për t'u folur njerëzvet, aftësia për t'ua mbushur mendjen atyre dhe për të fituar dashurinë e tyre, doemos është një dhunti, dhe ajo, siç kuptohet nga këto që shkruan Llukani, nuk i ka munguar Apostolit.

"***Me*** (përpjekjet) ***e Apostolit mësuan shumë vetë*** (shkrim e këndim shqip) ***dhe mbeti me ta mik për shumë kohë, sepse nuk përtonte e nuk mërzitej. Ishte popullor e i dashur me popullin. Kushdo që kish nevojë*** (e dëshirë për të mësuar)***, ai e ndihmonte. Ai nuk e pushonte veprimtarinë patriotike. Kënaqësia më e madhe e Apostolit, siç tregonin shokët e tij dhe me sa shikoja edhe vetë, ishte kur bisedonte me poullin për gjuhën dhe për shqiptarinë.***" (Ll.B.f.13-14)

"(Kur shihte dhe përjetonte mirënjohjen e njerëzvet) ***për punën që bënte, ai kënaqej***, (e ndiente të plotë) ***jetën***." (Ll.B.f.14) "***Abetaret ua jepte*** (fshatarëvet) ***falas, që të mësonin. Por u jepte edhe këshilla, që Abetaren ta ruanin, ta mbronin, se s'kish ku gjendeshin.***" (Ll.B.f.14)

"***Bisedonte me miq e me shokë*** (në grupe të vegjël), (por fliste me pasion) ***sidomos në vende publikë, ku kishte shumë popull. Fliste për gjuhën*** (dhe kërkonte) ***që ajo të përhapej në të mirë të krejt kombit***." (Ll.B.f.14) Do të shohim edhe më vonë sa e zotëronte dhe me sa sukses e shtinte në punë, ky veprimtar i palodhshëm talentin e oratorit. "**Fliste me pasion**," po e përsërisim çfarë shkruan Llukani, "***sidomos ku kishte shumë popull.***" (Ll.B.f.14)

"***E donte rininë dhe rinia e donte atë, sepse u mësonte*** (të rinjvet) ***këngë kombëtare dhe këndonte bashkë me ta. Shumë herë e linte punën, për të bërë biseda*** (ose për të kënduar)." (Ll.B.f.14) Ja, këtu po shikojmë edhe një tjetër dhunti të tijën: **Të kënduarit**. Ai këndonte shumë bukur dhe kjo i shërbente më së miri për t'u afruar me të rinjtë. E përfytyrojmë midis djemsh, fytyrëqeshur dhe zëëmbël. Ata i rrinë afër dhe e shoqërojnë, me të kthyer, me të hedhur dhe me iso. Por edhe me forma të tjera të të kënduarit, siç kishin filluar të përhapeshin në atë kohë këngët patriotike qytetare të Korçës.

"***Kur shikonte të ngjante ndonjë grindje, ai menjëherë do të ndërhynte dhe mbante qëndrim, për të treguar se të gjithë jemi shokë dhe se kudo jemi vëllezër shqiptarë***." (Ll.B.f.15) Të jesh pajtues, të jesh qetësues gjakrash të nxehur, prapë duhet të kesh temperament të veçantë. Nuk të dëgjon kush, nëse je i sertë, nëse nuk di të thuash pikërisht fjalën që duhet në kohën që duhet. Apostoli ish i kompletuar me të gjitha këto cilësi dhe prandaj mund të themi se ish një **tribun i vërtetë**, pikërisht i atillë siç e kërkonte epoka në të cilën po jetonte Kombi ynë.

Kish bërë që të funksionojnë **shkollat shqipe**, në formën e tyre vërtet origjinale, por të vetmen të mundshme, kur shteti ynë ende nuk ekzistonte, në Mezhgoran, në Krahës, në Koshtan dhe në Toç. Atje tashmë kish njerëz, të cilët dinin të lexonin e të shkruanin shqip, kish njerëz të frymëzuar me idetë për çlirimin e Atdheut dhe kish midis tyre të atillë që, edhe pas largimit të **Mësuesit të Madh**, do ta vazhdonin punën e tij.

Një e mirë e veçantë, që Apostoli e kish realizuar me shumë sukses në misionin e tij, ishte edhe **vëllazërimi ndërfetar**. Apostoli qe i krishterë, ortodoks, kurse nxënësit e tij, shokët e tij, miqtë dhe mikpritësit e tij, në fshatrat që i përmendëm, ishin që të gjithë myslimanë. Ish realizuar kështu një ndër idetë më madhore të Rilindjes sonë Kombëtare, ide e cila, për fatin tonë të keq, nuk funksionoi në krejt Shqipërinë. Psh, në Çamëri.

Cilësi zotëruese të Apostol Barkos ishin: mirësia, shpirti i tolerancës, zemërgjërësia, durimi, pasioni për të bërë punë të mira, por jeta rreth tij nuk ishte aspak e butë. Jeta rreth tij ishte e ashpër dhe e egër. Pushtuesit osmanë ishin ende aty, dhe nuk dihej kur do të shporreshin, ndërsa feudalët dhe nëpunësit e

Dovletit, jo të gjithë, por në shumicën e tyre, ishin në shërbim të pushtuesit. Kjo i revoltonte patriotët. Kjo ua shkurtonte jetën patriotëvet dhe, ja çfarë shkruan, fare shkurt, Llukan Barkoja:

"***Kish urrejtje të madhe ndaj pushtuesvet dhe ndaj feudalëvet shfrytëzues, që rrëmbenin të ardhurat dhe djersën e popullit. U mërzit nga kjo gjendje e mjeruar dhe vendosi që të largohet përsëri nga Shqipëria. Mori prapë rrugën e kurbetit, këtë radhë për në Amerikë. Shkoi në Argjentinë, në Buenos Aires***." (Ll.B.f.15) Të njëjtën gjë na thotë edhe Pano Rrumbullaku: "***Pasi u kthye*** (për fare, Gj.D.) ***nga mërgimi*** (në Bullgari)***, qëndroi 2-3 vjet dhe përsëri mori rrugën e kurbetit, këtë herë në Argjentinë.***" Por Pano Rumbullaku shton edhe këto: "***As atje nuk i eci puna mbarë, sepse shfrytëzimi kapitalist ishte i egër, por, megjithatë, nuk e ndërpreu veprimtarinë patriotike***." (P.Rr.1978)

NË ARGJENTINËN E LARGËT (1906-1914)

U largua në vitin 1906. U vendos në Buenos Aires dhe filloi menjëherë nga puna.

Në faqen 7 të shënimevet të tij Llukan Barkoja shkruan: "***Kishte në ngarkim: Mëmën Zogon, gruan Sotirën, çupën Konon dhe 2 djem, Lukanë dhe Dhimitraqnë***." (Ll.B.f.7) Në vitin 1906, të 5 këta pjesëtarë të familjes së tij të ngushtë, duhej të ushqeheshin prej punës së tij. Llukani ishte 4 vjeç, Dhimitraqi qe më i vogli. E vetmja që mund të punonte diçka në tokat dhe me bagëtitë, ishte e shoqja, Sotira (Tila). Vetëm kjo e dhënë mjafton të përfytyrohet se në ç'gjendje tmerrësisht të vështirë qe detyruar ta lërë familjen më 1906. Por Llukani nuk na tregon gjë tjetër lidhur me këtë anë, me anën e ekonomisë familjare të Apostol Barkos. Që ka qenë e vështirë, vetëkuptohet, por ç'ka mundur të dërgojë ai nga Argjentina, nuk e dimë.

Llukani shkruan: **"(Apostoli)** ***as në Argjentinë nuk e ndërpreu veprimtarinë në interes të çështjes kombëtare. Në Buenos Aires u takua me shumë shqiptarë: përmetarë, korçarë e kolonjarë, që kishin emigruar atje***." (Ll.B.f.16)

"***Në vitin 1907 në Buenos Aires formohet shoqëria 'Lidhja shqiptare'. Një nga iniciatorët e krijimit të asaj shoqërie ishte edhe Apostol Barkoja. Për meritat e***

tija në luftën për çështjen kombëtare, Apostoli zgjidhet anëtar i kryesisë dhe ngarkohet me detyrën e arkëtarit." (Ll.B.f.16) Për ta kuptuar edhe më mirë profilin moral të këtij atdhetari të papërkorë, kjo e dhënë ka rëndësi të posaçme. Të mos kishin besim të plotë te ai, shokët nuk do ta caktonin për t'u marrë me paratë e shoqërisë. Se ish i besueshëm, se ish i kujdesshëm dhe se ish, në pikëpamje arsimore, i përgatitur, prandaj dhe u caktua me punën gjithsesi shumë të rëndësishme të asaj shoqate.

Pano Rrumbullaku shkruan kështu: "***Duke shikuar një fotografi nga një manifestim i shqiptarëvet të mërguar në Argjentinë, bërë në vitin 1913, me rastin e përvjetorit të krijimit të shoqërisë shqiptare të atjeshme dhe kërkimit të të drejtavet për kombin shqiptar, për ruajtjen e lirisë e pavarësisë, menjëherë të shkon mendja … te ata patriotë që e formuan*** (atë shoqëri më 1907-n), ***njëri prej të cilëvet ishte Apostol Barko-Malëshova, anëtar i kryesisë dhe arkëtar i asaj shoqërie.***" (P.Rr.1978) Shënimi i Pano Rrumbullakut vazhdon: "***Shoqëria 'Lidhja shqiptare', një ndër iniciatorët e themelimit të së cilës ishte edhe Apostoli, ka në arkivin e saj një veprimtari të gjërë në favor të çështjes shqiptare. Ajo u dallua qysh në fillim për qëndrim të papërkulur në mbrojtjen e interesavet të kombit tonë, edhe në luftë, si kundër pushtuesvet otomanë, ashtu edhe kundër shovinistëvet të tjerë. Më 1908-n, kur dhespoti i Korçës e i Përmetit dhe Mitropolia e Përmetit u kërkuan ndihma përmetarëvet në Argjentinë, për të ndërtuar dy shkolla, që të mësonin fëmijët në gjuhën greke, patriotët përmetarë të kësaj shoqërie, në letrën e tyre drejtuar dhespotit, shkruajnë edhe këto fjalë: 'Për këto përparime, që Zotëria Juaj përpiqi, qofshin larg nga Shqipëria dhe shqipëtarët! Greqishtja për grekët dhe shqipja për shqipëtarët, që të marrim vesh se ç'është feja dhe kisha, se në greqisht që na këndoni, posi kafshë na përdorni.' Ndërsa Mitropolisë i shkruajnë: 'Neve dhe baballarët tanë, të mos kishim mësimin që mësuam e të kishim mësimin e vet, do të ishim shumë të lumtur e të përparuar së gjithash e nuk do të ripeshim e të vuanim në vende të largët. Ne jemi shqipëtarë e bij shqipëtarësh. Kur të bëni shkolla shqip, me gaz të madh do të ndihim, gunën do të shesim e ndihmës do të jemi.***'" (P.Rr.1978)

"***Megjithse larg Atdheut, ai mbante lidhje me patriotët shqiptarë dhe me shtypin patriotik, duke dërguar ndihma në të holla, letra dhe vjersha, të cilat i***

shkruante vetë." (Ll.B.f.16) Pra, Apostol Barko-Malëshova është edhe **vjershëtor**! Por kjo nuk është shumë e çuditshme. Edhe sot, thuajse çdo i dyti malëshovit është edhe poet. Për ndihmat në të holla, do të duhej sqaruar: A ishin ato ndihma kontribut i shoqërisë '***Lidhja shqiptare***', apo i çonte nga vetja?

Pano Rrumbullaku e përforcon kumtin e Llukanit, duke prurë edhe disa vargje të Apostolit: "***Nga ai vend i largët, ai mbante lidhje me shtypin shqiptar të kohës, dërgonte ndihma në të holla dhe letra e vjersha, në njërën prej të cilave, titulluar 'Fortesës së Tepelenës', duke i qarë hallin Mëmëdheut të dashur që lëngonte në robëri e mjerim, vargëzon:***

Ku ke, fortesë shkëlqimin,

Ku ke bukurinë e parë,

Ku ke forcën e gjëmimin,

Që jesh' e shquar e parë?" (P.Rr.1978)

Me sa shihet këtu, patrioti rilindës Apostol Barko-Malëshova nuk ka kurrfarë kompleksesh, që ndërtuesi i asaj kështjelle, Alipashë Tepelena, ka qenë ai, i cili, para 1 shekulli e gjysmë, ia ka pasë shkatërruar fshatin e të parëvet, Hormovën, dhe që, Barkajt, pikërisht prej zullumit të tij mezi kanë shpëtuar gjallë. Ai i shikon ngjarjet më me zemëgjërësi, larg çdo interesi të ngushtë apo sedre fisnore e personale. Dëshira e vetme e tija është: Atdheu të jetë sa më i fortë dhe prandaj i vjen keq që kështjella e dikurshme e Alipashait, dikur madhështore, të jetë katandisur tash në atë gjendje aq të mjerë. Edhe, shkruesit të këtyre radhëve, 100 vjet mbas tij, i vjen keq që kështjella e Tepelenës, për shkak se pushtetarët e atyshëm nuk janë njerëz vizionarë, vazhdon të "*jetojë*" jashtë çdo kujdesi bashkëkohor.

"***Në gjirin e shoqërisë 'Lidhja shqiptare',***" shkruan Llukan Barko, " ***Apostoli zhvilloi një veprimtari të dendur patriotike në interes të çështjes kombëtare. Qëndroi për një kohë të gjatë,* (kohë), *e cila karakterizohet nga një veprimtari e dendur patriotike.***" (Ll.B.f.17) Të dyja këto fjali kanë të njëjtën përmbajtje. Vetë shkuarja e tij në Argjentinë ka këtë domethënie: "***Desha të rrija në Shqipëri, po nuk ndenja dot.***" Kurse qëndrimi atje për 8 vjet, përmblidhet në kontradiktën që, në të vërtetë, e përjetonin shumica e mërgimtarëvet: "***Jam larguar nga Atdheu,***

po s'e harroj dot dhe s'e braktis dot." Apostoli kish vështirësi shumëfish më të rëndë, sepse ish krejt i vetëdijshëm: **Ç'do të duhej të bënte dhe ç'ish i detyruar të bënte.** Shtoji kësaj edhe dy gra, të jëmën dhe të shoqen, dhe tre fëmijë, që i kish lënë në pikë të hallit në Malëshovë!

Për ta përballuar këtë luftë të madhe të brendshme, o duhej t'i dorëzoheshe fatit dhe të shkëputeshe nga çdo gjë që të lidhte me vendin tend, o duhej t'i kushtoheshe një kauze, që të punoje, edhe atje larg, për të ndryshuar gjendjen në vendin tënd. Apostol Barkoja zgjodhi rrugën e dytë, doemos më të vështirën, por që ish e vetmja mënyrë, e cila do të mund ta mbronte nga asgjësimi, nga të treturit në botën amorfe të emigrantëve pa kurrfarë vlere **për vete**. Ai e dinte që, po t'i nënshtroheshe qoftë edhe për një çast harrimit, kush je e nga je, masa, grumbulli i pangjyrtë i botës së emi-imigracionit, do ta shndërronte sakaq edhe atë në një hiç të pangjyrtë.

Nuk kemi të dhëna të tjera dhe nuk mund të themi thuajse asgjë tjetër për veprimtarinë e tij 8-vjeçare në Argjentinë. Mbetet vetëm të shpresojmë që dikush tjetër, pas nesh, të shkojë në Buenos Aires dhe të hulumtojë, nëse ka mbetur gjë nga dokumentet e asaj shoqërie e, midis tyre, natyrisht, edhe për Apostol Barkon.

KTHIMI NË ATDHE DHE PERIPECITË

"(Gjatë kohës kur Apostoli ndodhej në Argjentinë*), nga Shqipëria kishin shkuar lajme të gëzueshëm. Në vitin 1912 në Vlorë ishte shpallur Pavarësia. Ishte plotësuar me këtë akt ëndrra më e madhe e patriotëvet shqiptarë*." (Ll.B.f.17)

"***Apostoli mendoi se kishte ardhur koha që, të gjithë patriotët shqiptarë, të mblidheshin e të punonin në Atdhe.*** (**Ai gjykonte**:) ***'Sot më shumë se kurrë ka nevojë Atdheu për krahun dhe për mendjen tonë.' Kështu, pasi siguroi një sasi të hollash, në vitin 1914, Apostoli i hipën vaporit dhe niset, i përcjellur me shumë dashuri nga shokët e shoqërisë 'Lidhja shqiptare'.***" (Ll.B.f.17)

Të njëjtin njoftim na e jep edhe Pano Rrumbullaku: **"*U kthye në atdhe në vitin 1914, por, mbasi e gjeti atdhuen të copëtuar e në rrëmujë, qëndroi në Vlorë e pastaj, nga veprimtaria tradhtare e pahait toptanas, së bashku me shumë shokë***

të tjerë, shkoi në Itali e më vonë në Shkodër, ku bashkëpunoi me Çerçiz Topullin, Muço Qullin e të tjerë.(P.Rr.1978)

Një tjetër autor malëshovit, Jorgo Premto, në librin me titull "***Kujtimet e mia***" (HARTFORD,CT, maj 2000), ka vendosur këta vargje të një kënge popullore kushtuar Apostol Barkos:

"***Apostol Barkua sa rroi***

Me Muço Qullin qëndroi,

Me Sali Butkën luftoi

Për Shqipërinë s'pushoi." (J.P.f.6-7)

Panua e bën përshkrimin edhe më konkret***: "Pasi në këtë qytet*** (në Shkodër, GjD.) ***vërshuan forcat pushtuese malazeze, ai qëndroi pak kohë i fshehur te shokët e atjeshëm dhe, me vështirësi të madhe mundi të largohet për në Berat e Skrapar, ku u lidh me patriotët vendës, ndërsa kur buçiti kënga 'Në konakë thërret tellali/ djema ju kërkon vatani!', ishte ndër të parët që u inkuadrua në radhët e luftëtarëvet të lirisë, në çetat e Sali Butkës, ku, si kuadër e luftëtar, ishte një ndër më trimat dhe mori pjesë me armë në dorë në të gjithë luftimet, gjatë të cilëvet fitoi dashurinë dhe respektin e luftëtatëvet të tjerë."***(P.Rr.1978)

Xhako Llukani shkruan: **"*Qe nisur nga Amerika me një vapor mallrah*,** (duke menduar se gjendja në atdhe do të kishte ndryshuar dhe se punohej për forcimin e shtetit të ri). ***Por, kur arriti në Sarandë, pa flamurin grek. U prek dhe tha me vete: 'Pse të jetë ky flamur grek këtu?'"*** (Ll.B.f.18)

"***Pyeti një nga hamejtë: 'More, nuk më thua se ç'kërkon këtu ky flamur grek?!' I thonë se Sarandën, Gjirokastrën, Korçën e Përmetin, i ka pushtuar Greku. Atëherë Apostolit i shpëtuan disa pika loti në faqe. 'Ç'ke?' I thanë punëtorët. 'Pse u mërzite?' 'Ç'do të kem tjetër? Ja, s'qenka kësmet të vete në shtëpi te familja!***'" (Ll.B.f.18)

Vetëm ky fragment i biografisë së Apostol Barko-Malëshovës do të mjaftonte për ta vënë emrin e tij **midis emravet më të ndritur të Kombit tonë**. Ato disa pika loti,

janë përmbledhja, koncentrimi, i lumenjvet të lotëvet të miliona shqiptarëve përballë shkretimevet që i kanë prurë këtij populli pushtimet njëri pas tjetrit.

Greku na e kish marrë gjysmën e Jugut në vitin 1913, Çamërinë, Janinën, Konicën, Kosturin, Follorinën, dhe, për atë gjysmë, kish marrë edhe vulën, bekimin e Evropës. Apostoli s'kish qenë këtu në atë vit të mallkuar, ardhur fill pas 1912-s, më të bekuarit vit të shqiptarëvet. Tash Greku kish shfrytëzuar Luftën e Parë Botërore dhe i kish marrë: Korçën, Kolonjën, Përmetin, Gjirokastrën, Sarandën. Kish marrë Malëshovën, kish shtirë nën sundimin e vet edhe tre fëmijët e tij, të cilët s'i kish parë prej tetë vjetësh!

Ç'mund të bëjë individi në të tillë raste?! Ku të përplaset?! Shumë njerëz, kur zbresin në tokën e të parëvet të vet, e puthin atë. Por, a mund të shuhet malli për atdhe, kur atë e gjen nën një flamur të huaj?! A mund të puthet ajo tokë?! (Unë, autori i këtyre radhëve, e kam provuar disa herë këtë shkrumb shpirtëror të Apostol Barkos.) Djegur nga malli për fëmijët dhe për bashkëshorten, ëndërruar e përfytyruar përqafimin e tyre me ditë e me javë, tek çante ujërat vapori, befas shkërmoqet si një send i qelqët që i bie njeriut nga duart.

Llukan Barkoja, mbështetur sigurisht në të treguarit e mëvonshëm të të jatit, shkruan: "***Mbeti i shastisur, i hutuar e shumë i dëshpëruar, se s'kishte si të vepronte. Donte të kthehej përsëri në Amerikë***." (Ll.B.f.19) Ne mund ta marrim me mend, sa shkatërruese është befasia e një të atillë të vërtete për shpirtin e një kurbetçiu, i cili vendos të kthehet prapë andej nga ka ardhur, duke lënë, mbi një rrasë të ftohtë, vetëm një pikë të vogël loti.

"***Por vapori do të shkonte nga Saranda për në Vlorë, për shkarkim mallrash. Qëndroi edhe Apostoli në po atë vapor… Në Vlorë u takua me shumë shokë, të ikur, nga Përmeti, Këlcyra, Tepelena, Mezhgorani e të tjerë, që ishin larguar nga vendi i vet prej ushtrisë greke***." (Ll.B.f.19)

"***Shumë prej të ikurvet Apostoli i njihte dhe e njihnin, sidomos mezhgoranasit. U takua me Mullarajt, të cilët ishin patriotë të flaktë, por u dëshpërua shumë, kur i pa në atë gjendje aq të rëndë. Njerëzit e ikur vdisnin nga rraskapitja dhe nga uria. Apostoli u mundua t'u jepte kurajë. U thoshte: 'Mos u mërzitni, se shpejt***

do të vemi në shtëpitë tona, do të vij edhe unë me ju dhe do t'i përzëmë grekët.'" (Ll.B.f.19) (Nuk po më përmbahen as mua lotët, kur po lexoj këta rreshta. Gj.D.)

"***Por, për fat të keq***," shkruan Llukan Barkoja, "***në Vlorë zbarkuan disa mbeturina, rebelë, të pashait toptanas dhe Apostoli nuk mund të qëndronte më aty***." (Ll.B.f.19)

Ne nuk e dimë ç'marrëdhënie konkrete kish, në vitin 1914, Apostol Barkoja me toptanasit. E dimë që ish kundër pushtuesvet osmanë dhe kundër **atyre** feudalëve vendës, që donin ta mbanin Shqipërinë të lidhur me Turqinë, e popullin donin ta mbanin nën shfrytëzim feudal. Por, deri në ç'masë ish konfrontuar ai, psh, me toptanasit, sidomos duke marrë parasysh që ai kish ndenjur 8 vjet jashtë Atdheut, për këtë nuk kemi të dhëna. Është e besueshme që ai të jetë konfliktuar me ta pikërisht në ato ditë, qoftë për shkak të qëndimit të tyre ndaj të ikurvet, qoftë sepse i quante fajtorë për gjendjen që ish krijuar në Shqipëri. Sidoqoftë, puna kish arritur deri aty, sa ai nuk mund të qëndonte më në Vlorë.

"***U takua me shokët e ikur***, (me refugjatët) ***patriotë***", shënon Llukani. "***Ata, kur mësuan largimin e tij, u mërzitën shumë. Po edhe Apostoli u dëshpërua që po ndahej. Patriotët mezhgoranas e përcollën deri te vapori për në Itali dhe u ndanë me mall e dashuri. Ai do të shkonte sërish në Amerikië***." (Ll.B.f.20)

Prapë nuk e kemi të qartë: Përse vendosi të bënte kështu? Mos i qenë mbaruar mjetet e jetesës? Mos nuk kish më para?! Në shtëpi nuk shkoi. Me familjen nuk u takua. Nga jeta e tij e deritashme, por edhe nga të konfrontuarit me njerëzit e Esatpashë Toptanit, i cilia mbante me vete rrëziqe jete, e kemi kuptuar që ai tashmë ishte **një personalitet i rëndësishëm kombëtar**. Por, a ishte zgjidhja e duhur, largimi prej Atdheut në ato rrethana?

"***Por vapori qëndroi në Itali***," shkruan Llukani, "***dhe Apostoli, pasi u takua me disa shokë atdhetarë, u ndal në Itali. Prej Italisë, u nis me shërbim për në Shkodër. Do të punonte si ndërlidhës me patriotët që gjendeshin jashtë.***" (Ll.B.f.20)

Shkonte, pra, **ME SHËRBIM** dhe detyra e tij ishte: "***Për t'u ndërlidhur me patriotët shqiptarë, Çerçiz Topullin, Muço Qullin e të tjerë, kundër planevet që po përgatitnin Mali I Zi dhe Sërbia.***" (Ll.B.f.20)

Sejfi Vllamasi, në librin e tij, na informon që, në ata muaj, shumica e patriotëvet qenë grumbulluar pikërisht në Shkodër.

"***Në atë kohë në Shkodër dilte gazeta 'Populli' e Muço Qullit***," shkruan Llukan Barkoja. "***Apostoli u strehua në një familje patriote të Shkrelajvet. Aty punoi bashkë me një pjesëtar të asaj familjeje. U takua me patriotët e shquar, Çerçiaz Topulli, Muço Qulli e të tjerë. Biseduan për luftën, për Shqipërinë dhe problemet e tjerë të kohës.***" (Ll.B.f.21)

Por Shkodra u pushtua nga malazezët dhe në të gjithë qytetin u shpall gjendje shtetrrethimi.

"(Një ditë), ***jo si ditësh tjera, kur takoheshin zakonisht me shokët atdhetarë, papritur vjen Çerçizi i alarmuar dhe me shpejtësi u thotë: 'Çohuni shpejt dhe të shpërndahemi nëpër baza të tjera, se jemi në rrëzik! Mlazezët na kanë diktuar dhe po na gjuajnë. Duan të na vrasin.***'" (Ll.B.f.21)

"(Patriotët) ***u çuan me të shpejtë dhe u takuan për të fundit herë. U shpërndanë me mall e dashuri dhe nuk u panë më kurrë. Apostoli me të shpejtë vajti në bazën e tij në Shkrelaj, ku strehohej, dhe i lajmëroi për ngjarjen.*** (Shkrelajt), ***shumë të dëshpëruar, e morën me të shpejtë Apostolin dhe e fshehën. Malazezët ishin të informuar se Shkrelajt strehonin një patriot shqiptar. U bënë shumë presione e kontrolle, por ata nuk e tradhtuan, se ishin vërtet atdhetarë***." (Ll.B.f.22)

"***Një natë të errët, vonë***, (Shkrelajt) ***e kanë marrë Apostolin me shumë kujdes se mos diktoheshin nga malazezët, dhe e kanë përcjellë, e kanë shoqëruar, deri në kufirin e pushtuesvet malazezë. Prej andej, Apostoli ka marrë rrugën për në Berat. Ka qenë viti 1915.***" (Ll.B.f.22)

"(Janë ndarë me Shkrelajt) ***me mall e dashuri të sinqertë dhe, kur Apostoli ka ardhur në shtëpi, pas 3-4 vjetësh, ka pasur letërkëmbim me ta për shumë kohë.***" (Ll.B.f.22)

"***Apostoli iku nga Shkodra dhe erdhi në Berat në vitin 1915. Por edhe në Berat qe detyruar të qëndronte ilegal, pasi Berati ishte i pushtuar nga forcat austro-hungareze, të cilat, edhe ato, si pushtuesit malazezë, i ndiqnin patriotët shqiptarë dhe e ndalonin çdo veprimtari patriotike shqiptare.***" (Ll.B.f.22-23)

"***Në Berat Apostoli u takua me një patriot nga Limari i Malëshovës, me Muharrem Grillin, i cili e strehoi deri sa Apostoli*** (u lidh e) ***u muar vesh me patriotët e shquar, me Themistokli Gërmenjin dhe*** (me) ***Sali Butkën, i cili ndodhej në afërsi, në zonën e Skraparit.***

U largua nga Berati nga fundi i vitit 1915." (Ll.B.f.23)

"***Mundi të merrej vesh me patriotët e vendit, Themistokli Gërmenjin dhe Sali Butkën, që ndodheshin në zonën e Skraparit dhe të Korçës, dhe mori pjesë me armë në dorë si pjesëtar i çetavet të lirisë, në të gjithë luftimet kundër pushtuesvet grekë e të tjerë***." (Ll.B.f.23)

"***Ka marrë pjesë në Betejën e Panaritit dhe në Betejën e Voskopojës kundër pushtuesvet grekë***. (Këto beteja) ***përfunduan me shkatërrimin e bandavet të pushtuesvet.*** (Ll.B.f.24)

***

Lidhur me pjesëmarrjen e Apostol Barko-Malëshovës në Betejën zulmëlargët të Panaritit, nuk kemi të dhëna më të hollësishme, por sa i takon pranisë së tij në djegien e llahtarshme të Voskopojës, kemi një pasazh nga libri me tregime historikë "***Plaku i Butkës***", të Sabri Godos, edituar nga Sht.Bot. "*N.Frashëri*", pa vit botimi. Po i sjellim fragmentet një nga një dhe po mundohemi të kuptojmë çfarë kanë përjetuar atë natë dy patriotët bashkëluftëtarë.

(16 tetor 1916, më të errur). ***"Në drejtim të Manastirit të Shën Prodhromit plasën dy zjarre njëherësh." "Zjarret ishin vënë në sektorin e Zenel Braçes." "'Ejani me mua ju të dy', u tha Plaku dy vullnetarëve që iu ndodhën afër."***

"Apostol Malëshova dhe Pandeli Karbanjozi shkuan pas tij. Ata i ranë lagjes përqark, duke u penguar në gurët e rrugës dhe pas gjysmë ore u gjendën në mes të çetës së Zenelit." (Plaçkitja kish filluar.) ***"Dy burra ngarkuar me diçka vrapuan të delnin nga qyteti."*** (S.G.f.252-253)

"'Qëndroni aty!' u thirri Plaku. Ata as ia vunë veshin fare dhe deshën të nxitojnë, por Apostol Malëshova që vinte pas, u zuri rrugën dhe u drejtoi pushkën." "(Njëri prej tyre) ***paskej qenë vullnetar i çetës së Zenelit, tjetri ish një fshatar nga Opari, kushëri i tiji."*** (Çeta e Zenel Braçes, pra, nuk po ndiqte andartët, por po plaçkiste shtëpitë e Voskopojës.) (Kishin ardhur edhe grupe kaçakësh.) ***"'Hiquni armët dhe i lidhni! Nesër do t'i gjykojmë.' i tha Plaku Apostolit."*** (S.G.f.253)

"Ndërsa Apostoli e Pandeliu po çarmatosnin ata të dy, një grup njerëzish u dukën në krye të rrugës." "Ishte komandanti i çetës, Zenel Braçja." "'Çfarë po bëhet këtu?!' e pyeti Plaku Zenelin. 'Tartari e marrtë vesh!' u përgjigj Zeneli." "Zeneli, si gjithnjë, diçka fshihte." "'Të tutë janë këta maskarenj që hapin sëndukët e grave?' tha Plaku." "(Pas pak, Plaku iu drejtua prapë Zenelit:) ***'Mba vesh mirë dhe vuri gishtin kokës! Po humbi plaçkë e po u dogj edhe një kasolle këndej e tutje, më përgjigjesh me kokë!'"*** (S.G.f.254)

As Sali Butka dhe as Apostol Malëshova nuk kishin dalë në luftë për të bërë plaçkë. Ata po e errnin jetën malevet e kurbetevet, për ta çuar krejt Atdheun në ditë më të mira dhe po luftonin për ta çliruar Atdheun prej çdo lloj zaptuesi, në këtë rast, prej grekëvet, si dhe prej çdo lloj zullumi. Zenel Braçia, komandant i njërës prej çetave, siç po shihej, s'ish i atij brumi dhe as i atij qëllimi. Ajo natë, do të ish një nga më të zezat net në jetën e Sali Butkës, por edhe të Apostol Malëshovës, i cili, siç vetëkuptohet, nuk ndodhej rastësisht afër Plakut historikrijues. Nuk ndodhej rastësisht, sepse edhe vetë Apostoli është njëri prej krijuesvet të pjesëvet më pozitive të historisë sonë kombëtare.

"***Çeta e Malkë Zvarishtit vret civilë, gra e fëmijë***." (S.G.f.262) Do thënë këtu që, Malkë Zvarrishti, një djalë-bishë nga një fshat i Gramshit, kish pasë parë lemeri me sy, kur, i lidhur me litarë mu në shtëpinë e tij, kish qenë i detyruar, duke uluritur, të shikojë se si ia përdhunonin andartët grekë të motrën dhe të shoqen. Por, me gjithë këtë, as Plaku i Butkës, as Apostol Malëshova, qoftë edhe sikur t'i

provonin vetë zullume të tillë, nuk do të mund t'ia lejonin, as vetes, as edhe të tjerëvet, të tilla forma hakmarrjeje, siç po i kryente i ziu Malkë Zvarrishti. Aq më tepër, kur ai po e shfrynte mllefin mbi popullin e Voskopojës, i cili historikisht ka qenë më i pafajshmi populll që njeh historia e këtij vendi. Por, ku e njihte Malka historinë?! Ai ish më shumë bishë, se sa njeri dhe ai mbante mend vetëm ç'i kishin parë sytë atë ditë, i lidhur me litarë.

"***Andartët***, (të cilët gjendeshin si pushtues në Voskopojë, ndërsa njerëz si Zenel Braçja dhe si Malkë Zvarishti, po '*hakmerreshin*' në fëmijë e në gra,) ***kanë çarë rrethimin*** (pikërisht në sektorin e Zenel Braçes) ***dhe janë zhdukur me mjegullën bashkë***." (S.G.f.262)

"(Ndërkaq), ***në Manastirin e shën Prodhromit*** (matanë luginës) ***qenkej bërë një vrasje në masë. E kish bërë Malkë Zvarishti.***" "(I kish therur) ***me thikë dhe copëtuar me duar 8 andartë***, (zënë të fshehur në një katua). (Kish lidhur 40 burra voskopojarë dhe i kish vrarë, duke provuar sa njerëz mund të shponte 1 plumb.)" (S.G.f.263)

Kjo ka qenë, pa dyshim, nata më e zezë në jetën e Apostol Barko-Malëshovës dhe ne nuk e dime: A mos ndoshta i ka shkuar nëpër mend atë natë atij njeriu, që nuk ia vlen të luftosh për lirinë e të këtillë njerëzve? Përkushtimi i tij i prushtë për ta arsimuar popullin, duhet të ketë pasur lidhje pikërisht me punët që duhen bërë për fisnikërimin e pjesës së pafisnikëruar të Kombit tonë.

***

Pikërisht këtë duket se thonë edhe shënimet e Xhako Llukan Barkos***: "Gjatë kësaj kohe, nga fillimi i vitit 1916, Apostoli punoi në çeta, vullnetarisht, për t'u mësuar pjesëtarëvet shkrim e këndim në gjuhën shqipe***." (Ll.B.f.24)

"***Më të shumtët e luftëtarëvet ishin analfabetë. Apostolin e donin (shumë), se, që të gjithë, mësuan*** (prej tij) ***për të shkruar e lexuar në gjuhën shqipe. Po kështu edhe ai kënaqej që vullnetarët e lirisë mësuan të shkruanin e të lexonin shqip***." (Ll.B.f.24)

"***Për meritë të sakrificavet në luftë e në punë për çështjen kombëtare, Apostoli u zgjodh anëtar i Komitetit Administrativ të Krahinës Autonome të Korçës për vitet 1916-1917. Kështu Apostoli jetoi e luftoi, me trimëri, (përkrah) Themistokli Gërmenjit e Sali Butkës, e shokëvet të tjerë patriotë, kundër okupatorëvet gjatë Luftës së Parë Botërore***." (Ll.B.f.24)

Mund të përfytyrohet këtu, sado që nuk kemi të dhëna më të hollësishme, e gjithë puna e tij e madhe, **VIZIONARE**, pikërisht në ditët dhe muajt e një lufte jashtzakonisht të rëndë. Ta kesh disa kilometra larg shtëpinë e të mos mund të shkosh atje për 4 vjet rresht! T'i vish rrotull shtëpisë e vendlindjes, Sarandë, Vlorë, Shkodër, Berat, Kolonjë, e të mos mund të shkosh një natë për të parë gruan dhe kalamajtë, është vërtet një peshë e rëndë shpirtërore, peshë, e cila e plak njeriun për katër ditë, jo më për katër vjet. Vendi i mbushur me ushtri e me flamuj të huaj! Me armë të huaja, me kafshë, me mbeturina veshjesh të huaja, konserva, kocka, lecka, lëkura! Pastaj: kufoma, njerëz të uritur, karvanë të ikurish, fëmijë, gra, edhe të përdhunuara, edhe të vrara!..

Të jetosh në vendin tënd e të detyrohesh të fshihesh herë këtu e herë aty! Herë të kthehesh në vaporin me të cilin ke ardhur, se s'shkon dot më tutje! Të shohësh në Vlorë mijëra të shpërngulur, shpërndarë nëpër ullishta! Të ikësh në Itali e të vish prapë në Shkodër, në përpjekje për të bërë diçka! Të jetosh i fshehur në një familje shkodrane! Pastaj të jetosh prapë i fshehur në një familje malëshovite, jo në Malëshovë, por në Berat! T'i kalosh të gjitha këto e të mos shkatërrohesh nga nervat, të mos luash mendsh, kjo do të thotë që je një njeri i jashtzakonshëm! **Apostol Barko-Malëshova ishte njeri i jashtzakonshëm**.

T'i përjetosh të gjitha këto, të bësh edhe luftë, ditën, natën, në të gdhirë, në të errur, të të kalojnë plumbat pranë veshëvet, dhe të kujtohesh për t'u mësuar njerëzve shkrim e këndim, të të rrijë mendja te shkronjat, te lufta kundër analfabetizmit, në mes të një katrahure të tillë, kjo do të thotë të jesh, jo i jashtzakonshëm, por mirëfilli madhështor. Apostoli na shfaqet kështu në përmasat e një heroizmi të pakundshoq. Heroizëm i veçantë, të cilin e manifestojnë vetëm njerëz të veçantë, në rrethana më se të veçanta dhe në popuj të veçantë.

"***Në fillim të vitit 1918, me vendimin e Komitetit e të shokëvet të tjerë, Apostoli u dërgua në fshat, në vendlindjen e vet, në Malëshovë. Në kundërshtim me dëshirën e tij, pasi ai mendonte të kthehej në fshat vetëm kur të mbaronte lufta. Por shokët insistuan*** (duke thënë) ***se ishte e domosdoshme të shkonte***." (Ll.B.f.25) Shokët e tij, sigurisht kanë pasur parasysh edhe faktin që ai kish 11 vjet pa vajtur në shtëpi. Fustanen e tij s'e kish larë e shoqja, për 11 vjet, as me ujë e as me lot. Le që as Tila s'ka qenë nga ato gra që e derdhin kollaj pikën e lotit. Edhe ajo, në mënyrën e vet, ka qenë një grua e jashtzakonshme.

"***Apostoli*** (pas këmbënguljes së shoqërisë dhe të udhëheqësvet) ***vendosi dhe u nis për në vendlindjen e tij, duke u përcjellë nga të gjithë shokët atdhetarë, si vëllezër. Me Sali Butkën në ballë, e uruan duke thirrur : 'Rrugë të mbarë, Apostol! Me sukses në punë e në luftë, për të mirën e Atdheut!'***" (Ll.B.f.25)

"***Shokët e tij luftëtarë, korçarë e kolonjarë, nuk e ndërprenë korrespondencën për një kohë të gjatë***. (Letrat që i shkruanin), ***kishin një vlerë të veçantë, se ai vetë*** (ua kishte mësuar alfabetin)". (Ll.B.f.25)

Fatkeqësisht, ato letra tashmë nuk ekzistojnë. Shtëpia e Barkajvet, sipas kallëzimit të Leonidhë Barkos, një herë u vodh prej njerëzish keqbërës, me ç'rast iu morën, midis tjerash, edhe librat dhe çdo gjë e shkruar, herën tjetër u dogj prej gjermanëvet më 1943. Më në fund, në vitin 1962, ajo shtëpi u shkatërrua dhe u zhduk për gjithmonë, nga rrëshqitja e tokës, duke marrë edhe jetën e një fëmije të asaj familjeje. Historitë e dhimbshme të shqiptarëvet nuk kanë të mbaruar.

Por edhe me kaq sa na informon Xhako Llukani, i cili ka jetuar me të jatin më gjatë se të gjithë dhe që i thotë gjërat pa kurrfarë shtesash apo pasaktësishë, ne kuptojmë, përveç vepravet të tjera të tijat, edhe punën e tij si **MËSUES**. Apostol Barko-Malëshova ka qenë **MËSUES**, njëlloj si Petro Nini Luarasi apo si Papa Kristo Negovani. Në thënshim që Apostol Barko-Malëshova mësimin e dha disi ndryshe, apo jetën, prapë, e dha disi ndryshe, ata gjithsesi bashkohen në një të vetmen pikë: Jetuan, punuan dhe **U SAKRIFIKUAN**, me dëshirën për ta parë Kombin e vet **MË MIRË** dhe… **M Ë T Ë M I R Ë**. Sidomos, **M Ë T Ë M I R Ë!** ***Më të arrirë***, siç do të thoshte Xh.G.Bajroni.

"***Na erdhi në fshat pa na lajmëruar. Ne, familja e tij, nuk kishim dijeni nëse rronte apo jo. Kur na erdhi, na dukej si e pabesueshme, se edhe ishte transformuar: Me mjekërr dhe me qylaf të bardhë***." (Ll.B.f.26) "***Shumë vetë çuditeshin, bëheshin kuriozë dhe, më vonë, e pyesnin: 'Pse mban mjekërr, o Apostol?' Ai u thoshte se e mbante mjekrrën për Shqipërinë. 'Po ja,' i thoshin, 'u bë Shqipëria.' Ai u përgjigjej: 'Jo kjo Shqipëri! Kur të bëhet Shqipëria e lirë, e plotë dhe demokratike, unë atëherë do ta heq mjekrrën.***'" (Ll.B.f.69)

Por nuk ia arriti dot deri në fund synimit të zjarrtë. Nuk ia arriti dhe as ne njëqind vjet pas tij, nuk e bëmë dot Shqipërinë tonë, **të plotë** siç e donte ai.

"***Qe një kohë shumë e gjatë pa u takuar dhe pa u parë. Disa plaçka, që i kishte sjellë nga Korça, i pat lënë në Përmet te një tregtar nga Limari, Dhimitraq Çemi***." (Ll.B.f.26) Zoica, nëna e Apostolit, ka qenë bijë te Çemët e Limarit, pra, i bie që Dhimitraqi të ketë qenë nga fisi i dajëvet të Gjysh Apostolit. (F.D.)

"***Përmeti në atë kohë ishte i pushtuar nga italianët***." (Ll.B.f.26) Ec e bëj jetë normale! Në një të atillë ***vit të mbrapshtë***, siç do të thoshte I.Kadareja, asnjë shqiptar nuk mund të bënte jetë normale.

"***I gjithë vendi ishte në gjendje lufte. Në Malëshovë kishin një poskomandë karabinierët italianë, kurse malit kishte mbeturina rrebelësh të andartëvet vorio-epirotë grekë***." (Ll.B.f.26)

"***Me të ardhur Apostoli në fshat, i erdhën për takim të gjithë shokët atdhetarë. Fshatarë nga Malëshova, fshatarë nga Leskajt e nga Limari. I erdhën të gjithë, se ishte larguar prej shumë kohësh***." (Ll.B.f.26)

"***Ky takim u kthye në një mbledhje të vërtetë, shumë të përzemërt. Që të gjithë e uronin që kish ardhur shëndosh e mirë në shtëpi, sepse kish qenë në luftë.***"(f.26)

"E përgëzonin me një dashuri të sinqertë. Po edhe Apostoli u kënaq shumë që u takua edhe njëherë me atdhetarët e bashkëfshatarët e vet. Së fundi u bënë shumë pyetje, si për luftën që po vazhdonte, për Shqipërinë dhe plot gjëra të tjera. Apostoli u përgjigjej me zjarr të gjitha pyetjeve, si për Luftën e Parë Botërore, për përpjekjet që bënin shumë patriotë e luftëtarë të ndershëm që

qenë hedhur në luftë për mbrojtjen e atdheut, lirisë e pavarësisë në të 4 anët.” (Ll.B.f.27)

“***U thoshte se edhe ialianët do t’i luftojmë dhe do të largohen nga Shqipëria, si edhe grekët, që tashmë ishin larguar***.” (Ll.B.f.27) Kjo thënie do kuptuar kështu: **Larguar prej pjesës që s’ua kishin dhënë ndërkombëtarët**. Përndryshe, grekët vazhduan t’i mbanin Çamërinë dhe të gjithë viset e tjerë jugorë të vendit tonë.

“***U fliste gjithashtu edhe për sukseset e arritur në këtë drejtim. ‘Prandaj’, thoshte ai, ‘është koha të bashkohemi, që të luftojmë armiqtë e Shqipërisë, kushdo qoftë.***’” (Ll.B.f.27)

“***Së fundi, e zuri në gojë edhe çështjen e shkollës shqipe, që duhej hapur në fshatin tonë***.” (Ll.B.27)

“***Të gjithë mbetën të kënaqur, kur u thoshte se edhe italianët do të largoheshin nga vendi ynë, si u larguan dhe grekët. Dhe së shpejti do të kemi një Shqipëri të lirë***.” (Ll.B.27-28)

“***Rrebelët, mbeturinat e andartëvet grekë, që vinin vërdallë malit si qentë e tërbuar, e morën vesh dhe e panë me sy, që, në fshatin Malëshovë, shpërtheu një lëvizje e gjërë patriotike për Shqipërinë e për gjuhën shqipe. Shumë herë Apostoli, me shokët e tij atdhetarë dhe me rininë, këndote këngë kombëtare, patriotike. Sidomos në ditët e festavet, ziente Malëshova nga këngët kombëtare.***” (Ll.B.f.28)

“***Mbeturinat e andartëvet grekë vendosën që Apostolin ta detyronin për të hequr dorë nga ajo veprimtari propagandistike për Shqipërinë e për gjuhën shqipe. Një ditë Apostoli po shkonte në Përmet, për të tërhequr plaçkat që pat prurë nga Korça. Me Apostolin vajti dhe e motra, Tila e Nanaj, e cila do të psoniste dhe do të merrte disa plaçka për vete. Rrebelët, mbeturina të andartëvet grekë, i bënë pritë Apostolit te Lisi i Dervishit*** (në mal).” (Ll.B.f.28)

“***Ishin 7 a 8 vetë. E ndaluan Apostolin, bashkë me të motrën. U sollën shumë keq, si egërsira, e kërcënuan barbarisht, duke përdorur fjalë e vepra të tjera, fyese dhe të ndyra. Vetëm sa s’e vranë. E quajtën dervish i Malëshovës, ngaqë mbante***

mjekërr. E fyejtën, duke i thënë: 'Qen bir qeni! Mbete këtu e po kërkon Shqipëri! Po na propagandon Shqipëri!' E kërcënuan se s'do t'i linin gjë pa bërë, në qoftë se nuk hiqte dorë nga propaganda shqiptare dhe në qoftë se fliste mirë për Shqipërinë e kundra Greqisë." (Ll.B.f.29)

Sado që Apostolit nuk i ka ndodhur mynxura në ato përmasa, episodi nuk mund të mos na e kujtojë të ziun Malkë Zvarrishti nga Gramshi. I ziu dhe tragjiku Malkë Zvarrishti dhe i ziu e tragjiku krejt ky popull, që nga Prokupla veriore deri në viset jugorë të Artës, sa shumë ka hequr prej babëzisë kriminale që na ka rrethuar!

"***Apostoli nuk u tremb , mbajti gjakftohtësi dhe të nesërmen lajmëroi shokët atdhetarë për të bërë një mbledhje. Pasi mbaroi mbledhja, ai u tregoi ngjarjen, kërcënimet dhe fyerjet e mbeturinavet të andartëvet. Të gjithë shokët i dënuan njëzëri veprimet e tyre dhe vendosën njëzëri t'u përgjigjen me një aktivitet më të madh. Rrebelët nuk e përsëritën më këtë veprim, kurse Apostoli nuk e ndërpreu veprimtarinë e vet patriotike, siç do të shohim edhe më poshtë. Ishte viti 1918***." (Ll.B.f.30)

Xhako Llukani thotë që rrebelët (Kupto: **Grekët dhe puthadorët e tyre**!) nuk e përsëritën më këtë veprim, por ato që do të lexojmë më poshtë, tregojnë se armiqtë e Kombit tonë nuk e kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre kundër Apostol Barko-Malëshovës për asnjë çast. Përkundrazi, e kanë intensifikuar atë veprimtari me gjithfarë formash, deri sa e kanë vrarë. Që grekët dhe puthadorët e tyre, nuk e kanë ndërprerë veprimtarinë e vet antishqiptare as sot e gjithë ditën, e dëshmon më së lakuriqti një **KISHË POLITIKO-STRATEGJIKE** dhe një **IMPROVIZIM** varrezash, **GJOJA DËSHMORËSH**, mu në Grykën e Këlcyrës.

SHKOLLA NË GJUHËN SHQIPE

"***Me iniciativën e Apostol Barko-Malëshovës dhe me përkrahjen e patriotëvet dhe bashkëfshatarëvet, u vendos që në Malëshovë të hapej, të çelej, të fillonte punën,*** **SHKOLLA SHQIPE**." (Ll.B.f.30)

E kemi thënë edhe herë të tjera, por tani është vendi për ta theksuar edhe njëherë: **Apostol Barko Malëshova është i të njëjtit rrafsh madhor e do të**

thoshim, edhe madhështor, me Papa Kristo-Negovanin, me Petro Nini-Luarasin, me Pandeli Sotirin e me Shtjefën Gjeçovin në krahun tjetër: Punëtor i arsimit e, më në fund, edhe dëshmor. S'ka dyshim që, ata që i morën jetën, kanë qenë edhe mospajtues me përpjekjet e tija për t'i arsimuar malëshovitët dhe të gjithë shqiptarët në gjuhën shqipe.

"***Në mbledhjen e bërë me këtë rast, Apostoli propozoi për të caktuar si mësues Dhimitraq Noten, një patriot i ndershëm. Për mbarëvajtjen e punës së shkollës dhe për të zgjidhur çdo problem që mund të dilte, si dhe për t'u kujdesur për rrogën e mësuesit, u ngrit një komision, në përbërjen e të cilit bënin pjesë edhe Kolo Haxhiu e Vasil Peçi.***" (Ll.B.f.30-31)

"***Për rrogën e mësuesit, edhe Malëshova,*** (vendosi dhe) ***veproi ashtu si shumë fshatra të tjerë në Shqipëri: Të mblidheshin paratë e rrogës shtëpi për shtëpi.***

Për lokal u sigurua një ndërtesë e vjetër, por që, me një punë të të gjithë fshatit, u rregullua disi. Megjithatë, fshatarët e shikonin me nderim këtë ndërtesë të vjetër dhe me një adhurim, sa s'kishin parë as kishat, as xhamitë." (Ll.B.f.31)

"***Arsyeja*** (që fshatarët e adhuronin këtë ndërtesë shkollore) ***ishte e thjeshtë: Kjo ndërtesë ishte*** **SHKOLLA E PARË SHQIPE**, ***ku do të mësonin fëmijët e tyre***." (Ll.B.f31)

"***Në mëngjesin e 5 marsit 1918, e gjithë Malëshova u gdhi në festë. Burra e gra, të veshur si për kremte e festë, u drejtuan te sheshi i vogël para shkollës. Kishin ardhur edhe nga Leskajt e Limari. Sheshi gjëmonte nga këngët patriotike***." (Ll.B.f.32)

"***Fëmijët qeshnin e këndodnin, duke shprehur kështu gëzimin e tyre. Por edhe gëzimi i të rriturvet ishte shumë i madh. Kur nxënësit filluan të hyjnë në klasë, u dëgjua një urim i përgjithshëm, drejtuar mësuesit: 'Me faqe të bardhë e me Shqipëri të lirë!'*** (Ll.B.f.32)

"***Pasi hynë nxënësit në klasë, Apostoli u dha atyre disa fletore e lapsa, si dhe dy-tri abetare, sa për të filluar mësimin. Më vonë do t'u jepnin të tjera. U shpërndanë nxënësvet edhe nga një shqiponjë dykrenore metalike. Apostoli i***

dhuroi shkollës edhe një flamur kuq e zi. Populli e përjetësoi në këngë këtë ditë të shënuar dhe skaliti në të figurën e iniciatorit kryesor, Apostol Barko-Malëshovës:

'Apostol, o trim i rrallë,

Çele shkollën shqip të parë,

Mësues vure Dhimitrajnë,

Në Limar vure Saminë,

Mësove shqip gjithë rininë.' (Ll.B.f.32)

E gjithë kjo e shtyn lexuesin të mendojë shumë gjëra dhe të bëjë shumë pyetje. Kush ish Apostoli? Ç'përfaqësonte Apostoli në atë fshat e në atë krahinë? Ai nuk qe një person i zgjedhur nga një forum i fshatit apo i krahinës. Ai nuk kish pushtet, as legjislativ, as ekzekutiv. Atëherë, si e dëgjonin fshatarët për të ndërmarrë të tilla nisma, të cilat edhe shteti e ka të vështirë për t'i realizuar? Duhej marrë vendimi dhe ai vendim duhej të ishte kolegjial. Duhej gjetur godina. Duhej meremetuar godina dhe aty, doemos, veç krahut të punës, që nuk do të paguhej, kish edhe shpenzime monetarë e materialë. Ku i gjenin, Apostoli dhe përkrahësit e tij ato para? Asnjëri prej tyre nuk ish i pasur. Ata ishin aq të varfër, sa nuk na është e qartë: Me ç'para ishin blerë ato fletore e ata lapsa, me ç'para ishin blerë ato flamurka metalike, ku ishin prodhuar ato flamurka dhe me ç'para ishte blerë ai falmur, që Apostoli ia dhuroi shkollës?

Asnjë hollësi lidhur me ç'po kërkojmë të dimë, nuk na thuhet. Mbetet vetëm konkluzioni ynë i përgjithshëm: Edhe ai, edhe shokët e tij, ishin vërtet njerëz të sakrificës. Ishin të sakrificës, por para se të bëheshin të sakrificës, ata ishin njerëz shumë të mençur, shumë largpamës, por edhe tepër praktikë. Ky është konkluzioni dhe kjo është e mjaftueshme për të thënë se, **jo vetëm Apostoli, por krejt ai brez ishte I LAVDISHËM**.

DITA E FLAMURIT

"***Flamuri shqiptar qe ngritur më 28 nëntor 1912 në Vlorë nga patrioti Ismail Qemali. Por në Malëshovë venin e vinin pushtues të ndryshëm me flamuj të ndryshëm. Aty nuk qe ngritur menjëherë flamuri shqiptar. Grekët pretendonin se Malëshova qe tokë greke dhe se i vetmi flamur që duhej të valonte aty, ishte flamuri i Greqisë. Por populli asnjëherë nuk e pranoi për të vetin atë flamur***." (Ll.B.f.33)

"***Në këtë kohë, grupet patriotikë të Përmetit e Gjirokastrës dhanë udhëzimin që, 28 Nëntori (1918), të festohet kudo si një festë e madhe. Këta udhëzime i erdhën edhe Apostolit në Malëshovë. Apostoli lajmëroi të gjithë shokët e tij për një mbledhje shumë të rëndësishme. Duke marrë fjalën, Apostoli ndër të tjera tha: 'Shokë atdhetarë! Shikoni, se më 28 Nëntor është festa më e madhe e Kombit tonë, FESTA E FLAMURIT. Duhet pa tjetër edhe këtu në Malëshovë ta festojmë këtë ditë dhe t'i tregojmë kështu botës se jemi shqiptarë e bij shqiptarësh. Këtu në Malëshovë, në këtë ditë, duhet të ngrihet flamuri shqiptar.' Pasi të gjithë shokët u shprehën me entuziazëm për festimin e kësaj dite, Apostoli vazhdoi: 'Mendoj që Festën ta bëjmë në oborrin e shtëpisë, pasi vendi është pak më i hapur dhe mund të mblidhen më shumë njerëz. Po kështu, është edhe në mes të fshatit, për çdo të papritur. Por ajo që ka më shumë rëndësi, është që edhe në Malëshovë duhet të ngrihet në këtë ditë flamuri shqiptar.' Të gjithë ranë dakord, si për ngritjen e flamurit, ashtu edhe për vendin.***" (Ll.B.f.33-34)

Pano Rrumbullaku shkruan: "***Me të ardhur në fshat, mori kontakt me patriotët e tjerë të rrethit e të krahinavet, hapi dy shkolla shqipe dhe organizoi ngritjen e Flamurit Kombëtar me një ceremoni madhështore, në të cilën morën pjesë edhe të ftuar nga fshatrat e tjerë përreth, gjatë së cilës Apostoli mbajti një ligjëratë të zjarrtë dhe lexoi një nga vjershat e tija, në të cilën thuhej:***

'Malëshovë, hallemadhe,

Turkut, Grekut nuk iu fale,

Luftove për abetare!

Malëshovë, shkëmb e gur,

Mbaje lart këtë Flamur!'" (P.Rr.1978)

Na bie në sy që **Festën e Flamurit** e organizojnë grupet patriotikë e jo shteti. Shteti shqiptar, pra, në vitin 1918, është i pushtuar, kurse dalëzotësit e vetëm të tij janë të quajturit ***GRUPE*****,** që, në thelbin e vet përbën një lloj partie nacionale. Një i tillë grup ekzistonte edhe në Malëshovë. Kjo shihet te fakti që ***SHOKËT*** e përkrahnin Apostolin, madje me entuziazëm. Por shihet që mund të ketë edhe të papritura. Për t'u dalë përpara atyre të papriturave, Apostoli vë në dispozicion shtëpinë e vet. Nuk është barrë e lehtë. Malëshova duhet të dëshmohet se është shqiptare. Malëshovitët duhet të dëshmohen se janë shqiptarë. Tashmë, mbasi ka ikur Turqia, janë të krishterët ata që duhet të dëshmohen se nuk janë grekë. Është meritë me vlera të madha që, jo vetëm Malëshova, por thuajse krejt pjesa e krishterë e Jugut tonë, e përfshirë brenda shtetit të 1913-s (Jo krejt. Psh, jo Pogoni, për të mos folur për më tutje.) diti të mbajë qëndrimin e duhur, si ndaj pushtuesvet të të gjithë llojevet, ashtu edhe ndaj përkatësisë së vet kombëtare dhe ndaj simbolevet, që e dëshmojnë solemnisht një të tillë përkatësi. Apostoli, në këtë rast, është vetë një **FLAMUR** dhe, shtëpia e tij, me gjithë mure e me njerëz brenda, është, që nga 1918-a e këndej, **SHTËPIA E FLAMURIT** në Malëshovë.

"***Atëherë, të gjithë iu futën punës me vrull e entuziazëm. Përgatitën një tra të lartë, 4-5 metra, dhe e vendosën në mes të oborrit të shtëpisë. U morën të gjitha masat dhe u lajmëruan të gjithë bashkëfshatarët dhe fshatrat përreth, që, më 28 Nëntor, të mblidheshin në Malëshovë***." (Ll.B.f.34)

"***Apostoli, me ndihmën e bijvet*** (Llukanit dhe Dhimitraqit) ***dhe bashkëfshatarëvet patriotë, ndezën qirinj në dritare dhe në muret e shtëpisë, duke krijuar kështu një atmosferë plot dritë festive. Në oborr të shtëpisë u ndez një zjarr i madh që ndriçoi gjithë vendin përreth. Të gjitha këto, Apostoli i bëri me qëllim që të tërhiqte vëmendjen e bashkëfshatarëvet, si për një ditë feste të shënuar, që duhej festuar me madhështi***." (Ll.B.f.35)

"***Gjatë natës (më 27 nëntor) Apostolin nuk e zinte gjumi nga gëzimi, ndaj dërgoi e thirri Vasil Peçin e Dhimitraq Noten, për ta kaluar bashkë atë natë të gëzuar.***

Posa gdhiu 28 Nëntori, herët në mëngjes, Apostoli, me Vasil Peçin dhe Dhimitraq Noten, doli në oborr dhe ngriti flamurin kuq e zi, me shkabë të zezë, të cilin e kish sjellë nga Korça.

Një flamur të tillë e mbanin edhe nxënësit e shkollës. Nxënësit kishin vënë në gjoks edhe shqiponjat metalike, të cilat ua kishte dhuruar Apostoli." (Ll.B.f.35)

Ndodhin këto ngjarje në një krahinë malore të Shqipërisë. Ka 450 vjet nga vdekja e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Po edhe në atë kohë, vetëm fryma e asaj Lufte kish arritur gjer aty, se sundimin e mbante Turqia qysh prej 1405-s, vit kur forcat osmane e patën shkatërruar gjer në themele Kalanë e Malëshovës, duke bërë që pjesa e mbetur gjallë e popullsisë të arratisej, për të mos u kthyer më kurrë. (Krs. Stilian Adhami). Kishin kaluar gjashtë vjet nga ngritja e këtij flamuri në Vlorë, por në Malëshovë s'ish ndodhur një Apostol Barko, që të bënte të njëjtën gjë. Prandaj, shihni si e presin njerëzit e thejshtë këtë ngjarje!

Llukan Barkoja shkruan: "***Shumë fshatarë, kur panë flamurin shqiptar, u habitën, pasi nuk e njihnin, se nuk e kishin parë ndonjëherë.***

Porsa u ngrit flamuri, Apostolit iu dha fjala dhe ai, duke dalë në mes të sheshit, pranë flamurit, tha ndër të tjera: 'Të dashur shokë, vëllezër e bashkëfshatarë, dhe ju miq e vëllezër të nderuar, ju përshëndes dhe ju falenderoj me zemër, që u mblodhët sot në këtë ditë feste pranë këtij flamuri!

Shokë, ky flamur që shikoni, është flamuri ynë kombëtar, që, për herë të parë në Shqipëri e ngriti në Vlorën heroike plaku i madh e i shquar i Mëmëdheut, Ismail Qemali.

Para afro 500 vjet, nën hijen e këtij flamuri, Skënderbeu i madh luftoi trimërisht kundra hordhivet të panumërta turke, të cilat i shkatërroi e i shpartalloi duke i mbuluar me turp për 25 vjet rresht.

Këto fitore i arriti në radhë të parë bashkë me djemtë e burrat e Shqipërisë dhe pa ndihmën e ndonjë fuqie tjetër të madhe, duke i treguar botës se ç'janë të zotë të bëjnë burrat e Shqipërisë, kur janë të bashkuar. Por, me vdekjen e

Skënderbeut, Shqipëria ra nën sundimin e Turqisë. Ky flamur i yni, së bashku me gjuhën shqipe, u bllokua nga Turqia për rreth 500 vjet.”” (Ll.B.f.36-37)

“***Nuk qe mjaft Turqia, por edhe shtetet fqinjë donin të na ndanin e të na copëtonin. Patriotët trima shqiptarë, ca me pushkë e ca me penë, ngado që ishin, luftuan trimërisht kundra hordhivet të panumërta, që nga Jugu në Veri***.” (Ll.B.f.37) Njëri nga ata trima, që luftoi, edhe me penë, edhe me pushkë, ishte edhe vetë ai që po fliste, Apostol Barko-Malëshova.

“***Tani ka ardhur koha, vëllezër, që ky flamur që shikoni, të valojë përsëri i lirë në qiellin e Shqipërisë. Nën të do të mblidhen të gjithë shqiptarët dhe do të lulëzojë gjuha shqipe e Shqipëria. Prandaj, vëllezër, sot duhet të bashkohemi si një trup i vetëm kundra çdo armiku që do të na godasë e do të na ngacmojë***.” (Ll.B.f.37) Llukan Barkoja, sigurisht, nuk ka mundur ta riprodhojë fjalimin e të jatit fjalë për fjalë, por ky duhet të ketë qenë thelbi.

“***Duke ngritur zërin, Apostoli thirri: ‘Rroftë flamuri ynë shqiptar! Rroftë kjo ditë e shënuar e madhe! Rroftë Shqipëria!’ I gjithë oborri, i cili dukej i vogël nga populli i shumtë që qe mbledhur, gjëmonte nga thirrjet: ‘Rroftë flamuri! Rroftë Shqipëria!’*** (Ll.B.f.37)

Pastaj këngët patriotike mbushën sheshin. Nxënësit, me flamur në dorë, këndonin këngë patriotike, të cilat i kishin mësuar në shkollë. I gjithë populli filloi të këndonte. Këndonin malëshovitët që qenë mbledhur. Të gjithë: burra, gra, fëmijë e pleq, këndonin. Pilo Bita, Kolo Ballua e tjerë, të ardhur nga Zheji, Vasil Mashua dhe të tjerë, nga Doshnica, Petro Konom Jarazi e Koço Xhani nga Mbrezhdani. Ashtu edhe banorët e Leskajt e të Limarit, që kishin ardhur të gjithë për të parë e përgëzuar flamurin.” (Ll.B.f.38) Fakti që aty kishin ardhur edhe nga Zheji, na bën ta përfytyrojmë këtë manifestim me përmasa më të gjëra se të një krahine.

“***Dita kaloi si një festë e gëzuar. Këtë ditë, populli e ka përjetësuar në këngë:***

“Apostol, o trim me mendje,

Erdhi dita ta përmendje

Nga gjumi krahinën tënde!

Apostol Barko me vulë,

Këtu keshe armiq shumë,

Po ti nuk u trembe kurrë:

Erdhe e ngrite flamurë!

Malëshovë, 1918." (Ll.B.f.38)

Te vargu i parë kemi vlerësimin më të madh: Trim, por trim me **MENDJE**! Vihet kështu në dukje gjithanshmëria e këtij udhëheqësi me përmasa heroi. Trim mund të jetë gjithkush, por kush ka **MENDJEN**, kush është edhe **I MENÇUR**, di ta përdorë trimërinë atje ku duhet dhe ashtu si duhet. Vargu i dytë dhe vargu i tretë, na flasin për një realitet shumë të hidhur dhe shumë trishtues, që përgjithësisht ka qenë cilësi e të gjitha krahinave tona: **Gjumi i rëndë**, prapambetja kulturore, prapambetja arsimore, si pasojë, edhe vetëdija e njerëzve e paarrirë. "***Të rreptë bijtë e Shqipes***," thotë Xh.G.Bajroni, "***veç të ishin më të arrirë***!" "***Trup e shpirt i sakatosur***!" Thotë Fan St.Noli ynë. Kështu del i shpjegueshëm edhe vargu i katërt "***Këtu keshe armiq shumë***". Realitet i dhimbshëm, zhgënjyes, por që kuptohet vetëm duke pasur parasysh terrin kulturor e rrjedhimisht edhe terrin moral, në të cilin gjendeshin shumë individë të atij ambienti.

E vetmja rrugëdalje ishte: Puna me përkushtim, trimëror dhe mençuror, e atyre që ishin ***TË ARRIRË***. Vetë fakti që, qysh atë vit, Apostolit iu këndua kënga, dëshmon që pjesa më e madhe e asaj krahine tashmë "***ish përmendur nga gjumi***".

RROFTË DJALI ME EMRIN SKËNDER!

"***Apostoli ishte frymëzuar nga idetë e rilindësvet, se 'feja e shqiptarit është shqiptaria'***. ***Qysh kur ishte në Buenos Aires, në biseda me shokët, kishte hedhur mendimin që edhe emrat të mos u viheshin fëmijëvet duke marrë për bazë fenë, por thjeshtë emra shqiptarë. Bile, në atë kohë, në shoqërinë 'Lidhja shqiptare', në gjendjen familjare që kishte dhënë, mua ma kishte ndërruar emrin nga Llukan në Flamur.***" (Ll.B.f.39)

"***Prandaj, për të bërë realitet këtë ide edhe në fshat, duke udhëhequr si gjithnjë me shembullin personal, shfrytëzoi rastin kur, më 20 shkurt 1919, i lindi një djalë. Atëherë Apostoli i vuri atij emrin SKËNDER. Kur u muar vesh nga patriotët shqiptarë kjo gjë, ata u kënaqën dhe u gëzuan shumë dhe erdhën të gjithë për të uruar për lindjen dhe emrin e djalit***." (Ll.B.f.39)

"***Por Apostoli mendoi që të mos e linte me kaq këtë punë dhe, për t'i dhënë një rëndësi këtij fakti, mendoi të organizojë një drekë me miq e shokë patriotë bashkëfshatarë. Na erdhën për të uruar*** (edhe) ***shokë e miq atdhetarë (të besimit mysliman) nga katundet Leskaj e Limar. Kështu, festa e djalit nuk kaloi thjeshtë si një festë e zakonshme familjare. U bisedua për shumë probleme, e në radhë të parë për luftën kundër*** (tendencavet përçarëse që në popullin tonë i kishin futur pushtues të ndryshëm)." (Ll.B.f.40)

"***Duke vënë në dukje edhe dëmin e madh që i sillnin*** (ato tendenca) ***Kombit Shqiptar, gjatë drekës u kënduan plot këngë patriotike dhe u bisedua për shumë probleme që e shqetësonin Shqipërinë e popullin shqiptar. Të ftuarit dhe miqtë që vinin, e uronin Apostolin me zë të lartë: 'Rroftë djali me merin SKËNDER!***'" (Ll.B.f.40)

"***Në fund, të gjithë kënduan këngë patriotike e popullore dhe u mbyll (gostia) mes një gëzim e hare të përgjithshme. Kur po largoheshin, miqtë e shokët, që të gjithë e uruan*** (prapë): ***'Rroftë djali me emrin SKËNDER!" Kështu, edhe një gëzim të zakonshëm familjar, Apostoli dinte ta vinte në shërbim të çështjes kombëtare. Ngjarja ndodhi në vitin 1919.***" (Ll.B.f.40)

Ish vërtet një emër domethënës. ***SKËNDER***, që e përdorin myslimanët, në të vërtetë, vjen nga ***ALEKSANDËR***. Kemi rënie të rrokjes nistore ***AL(E)*** dhe metatezë, ndërrim vendesh, nga ***KS*** në ***SK***. Por është edhe emri i dytë i **Gjergj Kastriotit-Skënderbeut**, i cili, i gjendur në oborrin e Sulltanit, e ka zgjedhur atë në nder të **ALEKSANDRIT TË MADH**.

Është vërtet një festë domethënëse, sepse në atë mënyrë po rivulosej një marrëveshje mjaft e hershme midis Barkajvet të krishterë dhe bashkëkrahinasvet myslimanë: **Të shkojmë mirë njëri me tjetrin**.

Thamë, të rivulosej, sepse e dimë tashmë që, qysh në fillim të sh.XIX, Protopapai i Barkajvet ka qenë vëllamëruar me Meçe Demirin e Leskajvet. Vëllamëri, e cila, nga një anë i ka kushtuar jetën Protopapait të Barkajvet, duke qenë se pushtuesit turq nuk na e donin një vëllamërim të tillë, e, nga ana tjetër, vëllami mysliman, Meçe Demiri, ia ka marrë gjakun trefish vëllamit të vet të krishterë.

Ngjashëm me historinë tronditëse të shekullit XIX, kemi edhe tani, në gjysmën e parë të shekullit XX. Këtë herë, jo nga turqit, por nga grekët. Apostoli ia vuri djalit emrin ***Skënder***, për t'u treguar të gjithëve sa e shtrenjtë është për shqiptarët shkuarja mirë midis fevet të ndryshme, por e la jetim, jo më të madh se 6 vjeç, djalin me emrin ***Skënder***.

Skënderi u rrit nën kujdesin vëllazëror të vëllait të vet, Llukanit, dhe, duam të theksojmë këtu, që **Skënder Barkoja**, ashtu si edhe Llukani, ka qenë një nga njerëzit më të mrekullueshëm të kësaj vëllazërie.

NË LUFTËN E VLORËS

"*Në vitin 1920 të gjitha forcat ushtarake që kishin pushtuar vendin tonë, ishin larguar. Vetëm forcat italiane mbanin të pushtuar Vlorën dhe fshatrat përrreth. Populli, i gjithi, rrëmbeu armët për të ndjekur nga vendi ynë pushtuesit italianë dhe për ta çliruar vendin."* (Ll.B.f.41)

"***Në atë kohë, bashkë me Apostolin, punonim në Teqe të Koshtanit në Mallakastrën e Sipërme. Që nga Koshtani, ku ishim ne, dukej shumë mirë zjarri i luftës e dëgjoheshin krismat e armëvet, që nga Tepelena, Dukajt, Martallozi, Sinanajt e Matohasanajt. Kur dëgjonte krismat e armëvet e shikonte zjarrin e luftës, Apostolin nuk e zinte vendi. Shpesh linte punën e shkonte e bisedonte me fshatarët koshtanakë, Teme Meton e të vëllanë, Belulin, e të tjerë. Biseda kryesore ishte lufta e popullit kundër pushtuesvet italianë. Ato ditë në Mallakastër shpërtheu një lëvizje e gjërë popullore në përkrahje të luftës çlirimtare."*** (Ll.B.f.41)

"***Me iniciativën e patriotëvet vendës, te Hani i Rërëzës, në Krahës të Tepelenës, u organizua një mbledhje e gjërë popullore, ku u rrah problemi i luftës. Apostoli***

shkoi në atë mbledhje bashkë me fshatarët koshtanakë. Në mbledhje Apostoli u takua me shumë shokë mallakstriotë, që njiheshin, si me Dervish Mediun, Kalo Brahimin, me vëllezërit e tyre, Salon dhe Hajredinin etj. U takua me Resul Axhemin e të tjerë fshatarë nga Toçi , me Arshi Shemen nga Tepelena, si dhe me shokë nga Kalivaçi, Drizara, Çorrushi e me mjaft fshatarë të mbledhur aty, nga Mallakastra." (Ll.B.f.42)

Xhako Llukani e trajton me kujdesin e duhur këtë pjesë biografisë së Apostolit. Në Mallakastër nuk është Apostoli ai që i bën organizimet. Janë të tjerët, janë vendësit, ata që i organizojnë bisedat dhe tubimet, ndërsa Apostoli është pjesëtar aktiv i asaj lëvizjeje. Në Malëshovë ai ka rrolin e organizuesit. Këtu është thjeshtë pjesëmarrës, por i rëndësishëm, sepse ai tashmë njihet midis patriotëvet si një nga autoritetet e shquar, të spikatur, të çështjes sonë kombëtare.

"***Në mbledhje folën shumë vetë*** (në lidhje me nevojën e shkuarjes) ***vullnetarë në luftë kundër pushtuesvet italianë. Foli edhe Apostoli mbi rëndësinë e mbledhjes dhe të luftës kundër pushtuesvet italianë.*** (Shumë nga të pranishmit dolën) ***vullnetarë*** (për të shkuar në luftë). ***Një ndër ta ishte edhe Apostoli***." (Ll.B.f.42)

Kemi të bëjmë këtu me një cilësi nga më të çmuarat e kombit tonë. Ka qenë traditë shekullore, te ilirët, te arbërit dhe te shqiptarët e sotëm, shkuarja në luftë për lirinë e vendit mbi baza vullnetare. Unë nuk e di sa e praktikojnë popujt e tjerë një të këtillë mekanizëm të shkuarjes në luftë, por te shqiptarët kjo është me të vërtetë një vlerë nga më të çmuarat. Nuk është lehtë të shkosh në një luftë, ku mund të vritesh. Nuk është punë e thejshtë, as për personin që vendos të shkojë për t'u vrarë, as për familjen që ta lejojë një pjesëtar të vetin të largohet ndoshta për të mos u kthyer më kurrë. Vetëm duke pasur parasysh këtë tablo arsyetimi, ne mund ta përfytyrojmë edhe vendimin që merr Apostoli për t'iu bashkuar vullnetarëvet të Mallakastrës e të Krahësit të Tepelenës. Ai kish shkuar atje për të mbledhur ndonjë para, se duhej të ushqente familjen. Kish marrë edhe djalin 17-vjeçar me vete. Në Malëshovë e priste Tila me fëmijën e vogël dhe me dy fëmijët e tjerë. Por Vlorën e kish zënë Italia dhe nuk e lëshonte. Këtu, qenia njerëzore e kapërcen kufirin e të qenit thjeshtë familjar. Këtu, hidhet poshtë çdo lloj egoizmi

dhe vihet në krye interesi i Atdheut. Të këtilla cilësi i gëzojnë vetëm popuj të zgjedhur dhe, brenda atyre popujve, njerëz të zgjedhur.

"***Kështu Apostoli u rreshtua në radhët e luftëtarëvet të Mallakastrës dhe luftoi gjersa u shporrën pushtuesit italianë nga vendi ynë.*** (Ngjarja ka ndodhur) ***në vitin 1920***." (Ll.B.f.42)

TRIM I MIRË DHE ME SHOKË

"***Po në vitin 1920, Apostolit iu kthye nga Stambolli një shok, patriot i mirë, Jano Keqi, malëshovit. Janua u bashkua me Apostolin, që ditën kur u kthye nga Stambolli. Ai erdhi i përgatitur, me ndjenja kombëtare shqiptare. Duke u shoqëruar me Apostolin, mori pjesë pothuajse në të gjithë aktivitetet e veprat patriotike që u organizuan në fshatin tonë në Malëshovë.***" (Ll.B.f.64)

Jano Keqi mori pjesë, krah Apostolit, në ceremoninë kushtuar V.I.Leninit, në ceremoninë kushtuar Avni Rustemit, në punët për edukimin e rinisë, dhe në çdo punë tjetër, bashkë me Stefan Nanon dhe të tjerë të rinj të krahinës. Këndonin këngë kombëtare, bashkë me Apostolin. Kështu thotë Llukan Barkoja në f.64 të shënimevet të tij dhe shton: "***Si Janua, ashtu edhe Stefani rrojnë dhe kanë shumë të dhëna dhe kujtime mbi jetën dhe punën e Apostolit, të cilët janë edhe komunistë, të dekoruar si patriotë të ndershëm. Të dy kanë marrë pjesë edhe në Luftën Nacionalçlirimtere dhe janë pensionistë***." (Ll.B.f.64) Mirëpo, për fat të keq, ne po i marrim nëpër duar këta shënime në vitin 2013. Këta dy shokë e bashkëpunëtorë të Apostolit, ka kohë që nuk rrojnë më.

"KANDIDAT E ZGJEDHËS I DYTË NË VITIN 1923"

Është kjo një shprehje që përdorej në sistemin zgjedhor shqiptar, në vitet e parë të konsolidimit si shtet, fill pas Kongresit shpëtimtar të Lushnjës. Xhako Llukani shkruan: "***Apostoli, qysh në fillim ka përkrahur idetë patriotike për një Shqipëri të lirë e demokratike. Ai ishte kundër qeverivet feudale që formoheshin në vendin tonë dhe luftonte kundër tyre me të gjitha forcat. Në saje të punës së tij të madhe dhe veprimtarisë së dendur patriotike, ai kishte fituar dashurinë e popullit dhe respektin e tij***." (Ll.B.f.50)

"(Prej meritavet të tija), ***si patriot, ai, në zgjedhjet e vitit 1923, në muajin nëntor, u zgjodh KANDIDAT E ZGJEDHËS I DYTË. Kur, në dhjetor 1923, u bënë zgjedhjet për në Asamble, ai votoi kundër Ahmet Zogut dhe pro Fan Nolit***." (Ll.B.f.50) "(Kuptohet), ***nuk e priti mirë ardhjen në fuqi të Ahmet Zogut, për të cilin ushqente një urrejtje të madhe, si për çdo shtypës e shfrytëzues të populllit***." (Ll.B.f.50)

Te shkrimi i Pano Rrumbullakut, më 29 janar 1978, lexojmë këta rreshta përmbledhës: "***Punoi në fshat dhe në rrethin e Përmetit për një Shqipëri demokratike, gjer në momentet e fundit të jetës së tij. Mori pjesë, më 1920, në luftën kundër pushtuesvet italianë dhe u bë përkrahës i zjjarrtë i mendimit më përparimtar të kohës, ndërsa në zgjedhjet e asamblesë në vitin 1923 ishte përkrahës aktiv i krahut fanolist dhe zgjedhës i parë.***" (P.Rr.1978)

"NDERIMI I LENINIT TË MADH. 1924, në Malëshovë." (Ll.B.f.43)

"***Emri i V.I.Leninit ishte i njohur në radhët patriotike dhe në masën e gjërë të populllit, në radhë të parë si udhëheqësi i Revolucionit të Tetorit dhe i shtetit të parë socialist në botë. Në rrethet e patriotëvet shqiptarë dhe në rrethet e gjërë të populllit, ky emër fitoi një respekt e dashuri më të madhe, kur çori traktatet e fshehtë të Fuqivet të Mëdha, të cilat donin ta*** (ri)***copëtonin vendin tonë.***" (Ll.B.f.43)

"***Apostoli ndodhej në Malëshovë, kur erdhi lajmi se në Bashkimin Sovjetik kishte vdekur Lenini. Në këtë kohë vjen edhe lajmi se, me iniciativën e Avni Rustemit dhe përkrahjen e patriotëvet të tjerë, Asambleja Kushtetuese e Tiranës ishte detyruar të mbante zi në shenjë nderimi për Leninin***." (Ll.B.f.43)

"***Apostoli, pasi bisedoi me disa shokë, vendosi të organizonte një ceremoni me rastin e vdekjes së Leninit. Për këtë, bëri një mbledhje me shokët patriotë dhe, pasi foli mbi veprën e Leninit, u shfaqi atyre mendimin e vet. Të gjithë ranë dakord për ta organizuar atë ceremoni. U morën masat që të lajmërohej populli dhe të njoftoheshin edhe fshatrat përreth.***" (Ll.B.43-44)

"***Mua dhe Jano Keqin na dërgoi të mblidhnim dafina dhe lule. Me ato lule e zbukuroi një fotografi të vogël të Leninit. Me dafina rregulloi një kurorë të vogël, në të cilën shkroi: 'Lavdi Leninit!' Në mes të kurorës vendosi fotografinë.***" (Ll.B.*f.44)*

Do të mjaftonte kjo ngjarje, e ndodhur midis një togu fshatrah malorë, emrat e të cilëvet zor se i dinte qoftë një shtetas sovjetik, për të kuptuar se çfarë drite shprese po shpërndante ai sistem i ri te popujt e varfër. Dhe mjafton t'i hedhim vetëm një sy botës së sotme, që të kuptojmë sa e kotë ishte ajo dritë shprese, për shkak se natyra njerëzore është e atillë që, e do drejtësinë vetëm sa është keq. Sapo t'i zërë luga lëng, njeriu (i paformuar) harron ç'ka qenë dikur dhe fillon të rendë pas "meritavet" dhe pas "komoditetevet".

"***Ditën e diel në mëngjes, me gjithë që ishte dimër, koha ishte e mirë me diell. Apostoli dhe Jano Keqi vunë një tavolinë në kishë, mbi të cilën vendosën fotografinë e Leninit, që ta shikonin të gjithë. Mbasi mbaroi mesha, populli u grumbullua pranë tavolinës, që të shikonte fotografinë e Leninit. Në një krah të tavolinës u vendos Sotir Laskua, mbasi ai ishte mësues i shkollës. Pas Taqe Notes nxënësit mbanin në dorë një flamur kombëtar në gjysmështizë***." (Ll.B.f.44-45)

"***Shumë nxënës mbanin në duar nga një flamur të vogël, që i kishin bërë Apostoli dhe Sotir Laskua. Në kishë ish mbledhur populli i tre fshatravet. Madje kishin ardhur dhe dy xhandarë, që ishin me detyrë në poskomandën e fshatit. Ata, me gjjithë uniformën e xhandarit, ishin atdhetarë të mirë. Edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare*** (20 vjet më vonë), ***ata mbajtën qëndrim të mirë***." (Ll.B.f.45)

"***Pasi u vendos qetësia, e mori fjalën i pari Jano Keqi, i cili foli mbi rëndësinë e mbledhjes dhe ia dha fjalën Apostolit. Në mes të qetësisë që kishte rënë, Apostoli u ngrit e tha: 'Shokë e vëllezër bashkëfshatarë të dashur dhe ju, shokë e vëllezër të Leskajvet e të Limarit, ju falenderojmë nga zemra për pjesëmarrjen në këtë ceremoni të përmortshme.'***

Mori në dorë fotografinë e Leninit dhe vazhdoi: 'Ky që shikoni, o shokë, mbrojti Botën nga mjerimi e shfrytëzimi. Ky u dha tokën fshatarëvet të varfër. Ky, o shokë, mbrojti edhe të drejtat e popullit shqiptar, sepse nxori në shesh dhe grisi

botërisht traktatet e fhshehtë të Fuqivet të Mëdha të Evropës, të cilat kishin bërë plane që ta ndanin Shqipërinë (Gj.D: rindanin) ***në copa e ta merrnin për vete. Por këto fuqi nuk ia arritën dot qëllimit të tyre, se rronte Lenini, i cili ua nxori në shesh të gjithë traktatet e fshehtë dhe ua prishi kështu gjithë planet.***

Ja, shokë, se si populli shqiptar e kishte një mik të madh, që e mbronte dhe e donte. Dhe, ky mik i popullit shqiptar e i gjithë popujvet të Botës, ishte Lenini. Por, ky mik, tani, o shokë, ka vdekur, nuk rron më. Për nderin e tij ju ftoj të mbajmë pesë minuta zi.'

Duke thënë këto fjalë, u ul më gjunjë në shenjë zie. Kështu bënë të gjithë. Xhandarët nderuan me rripat e kapelës, lëshuar në shenjë zie. Kur mbaruan minutat e heshtjes, njerëzit u ngritën në këmbë e thanë: 'I paharruar qoftë kujtimi i tij!'

Pastaj Apostoli, në mes të një grumbulli të madh njerëzish, fliste mbi veprën e Leninit, njeriut më të madh të Botës, siç e quante ai. (Ll.B.f.46)

Është prapë diçka tepër e veçantë të përfytyrosh atë grumbull fshatarësh, në mes të Malëshovës malore, mijëra kilometra larg Moskës, se si ulen në gjunjë përpara një fotografie fare të vockës, madje në një kishë. V.I.Lenini ishte ateist, këta ia bëjnë nderimin në kishë. A ka ndodhur në ndonjë vend tjetër të Botës që, atij udhëheqësi të Revolucionit Proletar, ceremonia e përmortshme t'i bëhet në kishë?! Veç kësaj, na bie në sy heshtja pesëminutëshe. Aq thellë e ndiente Apostoli, jokomunist, dhimbjen e humbjes së atij mbrojtësi të Shqipërisë, sa i dukej pak një minut heshtje.

PËRKUJTIMI I AVNI RUSTEMIT

"*Më 20 prill 1924, nga një agjent i Ahmet Zogollit, plagoset patrioti i shquar Avni Rustemi dhe, pas 46 orësh, vdes. Vrasja e tij shërbeu si sinjal i kryengritjes. Më 1 maj 1924 bëhet varrimi i tij në Vlorë*. (Ai varrim) ***u shndërrua në një manifestim politik që s'qe parë ndonjëherë në Shqipëri.***" (Ll.B.f.47)

"***AVNIU DËSHMOR, IDEALI I TIJ I GJALLË. Me këto fjalë populli i jepte lamtumirën e fundit Avniut. Në këtë kohë Apostoli, (***prapë,***) ndodhej në***

Malëshovë. Kur mori vesh lajmin e vrasjes së Avniut, mendoi që të organizojë një ceremoni të përmortshme (edhe për Avniun), ***me pjesëmarrjen e gjithë popullit. U lajmërua populli i Malëshovës, i Leskajt e i Limarit, se 'ditën e diel do të organizojmë përmortjen e patriotit të shquar Avni Rustemi'***."

"***Fotografinë e Avniut e zbukuruan me lule e dafina dhe e vendosën mbi një tavolinë në kishë***." (Ll.B.f.47) Prapë këtu kemi një veprim në dukje kontradiktor të Apostol Barko-Malëshovës, por që, në të vërtetë, është një lajmërues i kohëvet të reja. Apostol Barko-Malëshova, në këta dy veprime, në veprimin me V.I.Leninin komunist, që e fut në kishë, dhe në veprimin me Avni Rustemin mysliman, që gjithashtu e fut në kishë, na duket sikur sjell aty, jo shekullin XX, në të cilin jetonte, por shekuj të tjerë, të cilët do të vinin më pas. Ishte forca e frymëzimit rilindës, që i kish dhënë mundësi atij ta shikojë të ardhshmen krejt qartë, siç shikohet një pejsazh që e ka njeriu konkretisht përpara syvet.

"***Ditën e diel të gjithë njerëzit e tre fshatravet u mblodhën në kishë. Sotir Laskua kishte ardhur bashkë me nxënësit, të cilët mbanin në dorë një flamur kombëtar në gjysmështizë, në shenjë zie.***" (Ll.B.f.47)

Nipi i Apostol Barkos, Leonidhë Llukan Barko, në shënimet e tij, jep një "hollësi" që Llukan Barkoja nuk e ka shënuar. "***Të dielën kisha e Malëshovës u mbush aq shumë, sa shumica qëndruan jashtë kishës.***

Myslimanët, me në krye Hysen Kason nga Limari, kishin ardhur të armatosur. Pa filluar mesha, u bë një grindje e forte. Fanatikët e krishterë e kritikuan priftin se 'po turqepste kishën', pasi nuk lejohej që të qahej në kishë një mysliman dhe (thanë se) për këtë do të njoftohej dhespoti. Por prifti, tepër i inatosur nga kërcënimi, duke tundur temjanin, bërtiti aq fort, sa dëgjuan edhe njerëzit që ishin jasht: 'Avni Rustemi nuk është turk! Është shqiptar e bir shqiptari! Është komshiu ynë nga Libohova! Ai vrau tradhtarin Esatpashë Toptanin, që e shiti Shqipërinë tek Sërbi dhe tek Greku! Kush është shqiptar, të rrijë me ne në kishë, kush nuk është shqiptar, të dalë jashtë!'" (L.Ll.B.f.9-10)

"***E mori fjalën Apostoli*** (shkruan Llukan Barko)***, i cili ndër të tjera tha: 'Të dashur vëllezër e shokë bashkëfshatarë e ju, të dashur shokë e vëllezët të Leskajvet e***

Limarit, ju përshëndes nga zemra për këtë pjesëmarrje në këtë ceremoni të përmortshme, të rëndësishme, politike!' Mori në dorë fotografinë dhe vazhdoi: 'Ky që shikoni në këtë fotografi, është patrioti i shquar Avni Rustemi…

Avni Rustemi ka qenë kundër bejlerëvet, feudalëvet, arhondëvet të pasur, që shtypin e shfrytëzojnë popullin. Ky atdhetar trim (dhe e puthi fotografinë) ka bërë një vepër shumë të madhe për Shqipërinë e popullin shqiptar. Ky është ai që vrau, në mes të Parisit, katilin dhe tradhtarin me damkë, kuçedrën e Shqipërisë, gjakpirësin e popullit shqiptar, i cili akoma donte ta shiste Shqipërinë te fqinjët, që të mbushte qesen e tij me para, tradhtarin Esatpashë Toptani." (Ll.B.f.48-49)

"***Esatpashë Toptani ishte dajua i feudalit të madh të Matit, Ahmet Zogollit dhe, këtë patriot të madh e trim të Shqipërisë, befas na e vranë (pikërisht) kriminelët e Ahmet Zogollit. Na e vrau Zogolloviçi!.. More!.. Zogolloviçi!.. Prandaj, o vëllezër bashkëfshatarë e ju, të dashur nga Leskajt e Limari, për ato merita të mëdha të këtij patrioti shqiptar, dhe për të bëmat e tija për Shqipërinë e popullin shqiptar, ta nderojmë me pesë minuta zi!***" (Ll.B.f.49) .

"***Duke thënë këto fjalë, u ul më gjunjë në shenjë zie. Kështu u ulën të gjithë dhe, kur mbaroi pesëminutëshi i heshtjes, të gjithë thanë: 'I paharruar qoftë kujtimi i tij!'***

Së fundi biseduan mbi punët dhe të bëmat e Avni Rustemit.

Kështu u organizua në Malëshovë përmortja e Avni Rustemit më 7 korrik 1924." (Ll.B.f.49)

Krejt këtë ngjarje e vërteton edhe Pano Rrumbullaku. Ai shkruan: "***Me rastin e vrasjes së patriotit të shquar Avni Rustemi, organizoi një ceremoni të përmortshme, ku vuri në dukje meritat e mëdha të tijat në shërbim të Atdheut dhe demaskoi e dënoi vrasësin Ahmet Zogolli. Duke qenë një aktivist i tillë, mori pjesë në revolucionin e Qershorit 1924 dhe përsëri rrëmbeu armët në duar për ta mbrojtur atë në dhjetor.***" (P.Rr.1978) Del kështu që Apostol Barko-Malëshova ka marrë pjesë me armë në dorë, në katër luftëra.

"***Vrasja e Avni Rustemit,"*** shkruan Xhako Llukani***, "shërbeu si sinjal i kryengritjes që po piqej prej kohësh. Revolucionin e Qershorit Apostoli e priti me gëzim. Ai menjëherë u hodh në mbrojtje të tij. Pas triumfit të Revolucionit, Apostoli u nis e shkoi në Tiranë, ku u takua me Fan Nolin. Në këtë takim Apostoli bisedoi gjërësisht me Fan Nolin dhe mori prej tij*** (porositë) ***se si duhej të punonte***." (Ll.B.f.51) Shprehja, kumti "***u hodh në mbrojtje***", përmban në vetëvete një varg veprimesh, që do të duheshin përshkruar. Por Xhako Llukani na thotë vetëm kaq. Çfarë bëri me atë rast? A mblodhi njerëz rreth vetes? A veproi për ta rrëzuar pushtetin lokal me forcë, qoftë edhe me armë? Shkuarja menjëherë në Tiranë dhe pritja që i bën Fan St. Noli, dëshmojnë që Apostol Barko-Malëshova shkonte atje si personalitet. Fan St. Noli bisedon me të gjërësisht, por çfarë u tha konkretisht? Ç'duhej të bënte Apostoli në Malëshovë e më gjërë? Madje, të bisedohet me Kryetarin e Shtetit për një Malëshovë do të ishte punë mjaft e vogël. Duhet të jetë biseduar diç më tepër se aq, por ne nuk e dimë. Nuk dimë, madje: A është protokolluar apo stenografuar biseda, apo janë bërë gjërat në mënyrë verbale, praktikë që edhe mund ta ketë favorizuar dështimin e Revolucionit?

"***Apostoli u kthye në fshat bashkë me Leonidhë Frashërin e Koço Tasen, me cilësinë e Komisionerit të Qeverisë së Fan Nolit dhe filloi t'i fliste popullit për rrugën e përparimit. Në një bisedë të tillë ai tha: 'Duhet të ngrejmë spitale e maternitete edhe në fshatra e sidomos në Malëshovë. Pasi t'i kemi ngritur (këta institucione) t'i kërkojmë Qeverisë që të na dërgojë personel mjekësor.' 'Por ne s'kemi para!' Ndërhyri dikush. 'Unë them që kemi!' Vazhdoi Apostoli. 'Ja, një vit nuk e festojmë Shën Mitrin. Në fshat jemi 130 shtëpi. Të gjithë shpenzimet i përdorim për të ngritur spitalin.'"*** (Ll.B.f.51-52) Detyra e Komisionerit nuk është e vogël. Por, a kjo ish puna e tij konkrete? A mund të punohej për spitale e maternitete, pa ngritur më parë pushtetin ekzekutiv vendor, pa krijuar e konsoliduar xhandarmerinë apo çfarëdo force të armatosur? Dua të them: Vullneti e preokupimi, qoftë në qendër, i personifikuar te një Fan Nol, qoftë këtu, në terren, e përfaqësuar nga një Apostol Barko, nuk mungonte, por teoria dhe praktika e të bërit të shtetit duhet pranuar se ishin tepër të mangëta.

"***'Bisedojmë me vëllezërit tanë në Leskaj e Limar.' Tha Apostoli. Por Qeveria e Fan Nolit nuk u tregua e vendosur për të zbatuar programin e saj demokratik.***

Ahmet Zogu, me ndihmën e shovinistëvet fqinjë, hyri nga toka jugosllave dhe rimori pushtetin." (Ll.B.f.52) Natyrisht që kështu do të përfundonte. Sado që Xhako Llukani e thotë që Apostoli mori pjesë në mbrojtjen e Revolucionit me armë në dorë, rezultati del që ato armë nuk u përdorën në mënyrë efikase.

MËRGIMI I FUNDIT - LARGIMI PËRGJITHMONË

"***Apostoli ishte ndër të parët që u radhit në mbrojtje të Revolucionit me armë në dorë. Me ardhjen e Zogut në fuqi, për të gjithë patriotët dhe demokratët në vendin tonë u krijua një gjendje e rëndë. Kështu, një pjesë e madhe u detyrua të merrte rrugët e mërgimit***." (Ll.B.f.52)

"***E pa se, po të qëndronte në Shqipëri, do të ishte vazhdimisht në ndjekje, ndaj vendosi të merrte rrugën e kurbetit, larg Atdheut. Në vitin 1925, Apostoli, bashkë me Dhame Pucin e Leonidhë Premton, shkoi në Tiranë, për të marrë vizën e për të dalë jashtë shtetit si emigrant ekonomik. Vizën e kërkuan për në Amerikë. Por zogistët nuk ua dhanë për atje, pasi në Amerikë patriotët shqiptarë zhvillonin një aktivitet të dendur patriotik."*** (Ll.B.f.52-53)

"(Pasi nuk morën dot për në SHBA, ata) ***u detyruan të marrin vizë për në Kubë. Kështu, bashkë me të dy shokët e tij dhe me të birin, Dhimitraqin, Apostoli u nis për në Kubë. U vendos në Havanë dhe filloi punën në një fabrikë sheqeri.***

Në atë kohë në Havanë kishte shumë emigrantë grekë, të cilët ishin organizuar në shoqëritë e tyre dhe merrnin udhëzime nga Greqia. Ata u bënë thirrje Apostolit dhe shokëvet të tij që të hynin edhe ata në shoqërinë e tyre.

(U thoshin): ***'Edhe ju jeni grekë. Jeni vorioepirotë. Por Apostoli, jo vetëm që s'pranoi kërkesën e tyre, por edhe e demaskoi propagandën shoviniste greke. 'Ne jemi shqiptarë e bij shqiptarësh dhe vetëm për Shqipërinë do të punojmë.' U ka thënë Apostoli. Ky qëndrim i ka zemëruar shumë agjentët grekë, ndaj ata filluan ta provokonin dhe ta fyenin, bile edhe në vende publikë."*** (Ll.B.f.53-54)

Nuk mund të kalohet këtu, pa bërë një krahasim dëshpërues, madje revoltues, jo vetëm nga pikëpamja kombëtare, por edhe në aspektin thjeshtë njerëzor.

Apostol Barkoja, në Kubën e largët, me një grusht shokësh, me një barrë problemesh ekonomikë, madje edhe shëndetësorë, sepse djalin e ka në spital, nuk e pranon alternativën për ta quajtur veten grek. Merr parasysh konfliktet, merr parasysh shantazhet dhe përbuzjet nga pala injorante dhe e paqytetëruar greke, merr parasysh madje edhe rrëzikun për jetën, por nuk pranon ta mohojë vetëveten. Djalin e lë sëmurë në një spital të Havanës, vetë bie në kurthin e të pakultururvet grekë dhe vritet. E vrasin, madje edhe e hedhin në det, pamëshirshëm, pa menduar se edhe ai është njeri dhe se edhe ai ka nevojë për një varrosje njerëzore. Ata janë aq të prapambetur, sa mendojnë që kanë të drejtë të vrasin mizorisht një njeri, i cili, megjithse është ortodoks, nuk pranon të quhet grek.

Në një kohë kur kemi parasysh një qëndresë fare të logjikshme dhe fare të thejshtë, të një banori të Malëshovës, i cili quhet Apostol Barko, na shfaqen: 1000, 10 mijë, 100 mijë shqiptarë, të cilët, për një shikim dashamirës të një fanatiku greqishtfolës, që s'di as vetë çfarë është, apo edhe për ndonjë gjë pak më të madhe se shikimi dashamirës, pranojnë të ndërrojnë emrin, të lënë mënjanë gjuhën e vet dhe të shkruhen grekë.

Unë shtroj tani pyetjen: A janë më të moralshëm se Apostol Barkoja këta njerëz, a janë më të mençur, a janë praktikë në jetë, dhe, në fund, a janë më të fituar apo më të humbur se Apostol Barkoja, këta 1000, 10 mijë apo 100 mijë njerëz? Apo mos janë qyqarë, me vlera më të pakta se mizat?! Sepse, Apostol Barkoja e mbylli jetën 50 vjeç. Humbi edhe djalin 18 vjeç. Këta që e mohuan qenien e vet dhe i thanë vetes grek, turk apo malazez, do të rrojnë, jo me siguri të plotë, edhe 50 vjet më shumë. Ç'fituan?! Çfarë do të fitonte një grek, nëse do ta quante veten shqiptar, për hir të një përfitimi të çastit? Çfarë do të fitonte një sërb, në rast se do ta quante veten shqiptar, për ta marrë me të mirë shqiptarët?

Shtrohen këto mbi baza gjithnjerëzore: Sa vlen më shumë një njeri hipokrit, se një që nuk është hipokrit?!

"***Por, nga Apostoli merrnin gjithnjë të njëjtën përgjigje. Gjendja u acarua së tepërmi. Apostoli i porositi shokët që të kishin kujdes nga kurthet e grekëvet.***

Duke parë se qëndrimi në Havanë po bëhej i pamundur, Apostoli mendoi që të shkonin në Amerikë (SHBA, Gj.D.), ***pasi atje nuk do të ishin vetëm, por do të kishin shumë shokë.***" (Ll.B.f.54)

"***U tha shokëvet që ai vetë të nisej para, me qëllim që të interesohej për punë dhe më vonë të vinte dhe t'i merrte edhe ata. Shuaip Kasua iu lut Apostolit që të niseshin bashkë. Dhe, kur Apostoli pranoi, Shuaipi u interesua që të shiste një dyqan të vogël, që e kishte në Havanë. Kur e shiti dyqanin, Shuaipi filloi t'u linte shëndenë e të takohej me miqtë e me shoqërinë e tij në Havanë.***

Ditën e fundit që anija do të nisej (ndërsa Apostoli kishte hipur në anije), Shuaipi shkoi të takonte një shok grek, me të cilin kishte punuar disa vjet. 'Me cilin vapor do të shkosh?' E pyeti greku… Kur Shuaipi i tha emrin e anijes, ai i tha: 'Vetëm me atë vapor të mos ikësh! Gjej vapor tjetër! Ka vaporë sa të duash. Por me atë jo!… Ai fshatari yt le të iki, por ti s'duhet të ikësh.' 'Po pse, mor.?!' E pyeti Shuaipi. 'Kaq të them unë.' I tha greku. 'Këto t'i thashë, se të kam shok e më ke ndihmuar. Më shumë mos më pyet, se janë punë politike dhe ti e kupton vetë që s'bëhet shaka me këto gjëra. '" (Ll.B.f.54-55)

"***Shuaipi, i cili dyshoi për diçka të keqe në këtë mes, nxitoi të gjente një varkë, që të shkonte në anije e të njoftonte Apostolin për bisedën me grekun. Gjatë kohës që Shuaipi kërkonte varkë, anija u nis para kohe dhe kështu nuk u njoftua Apostoli për kurthin e përgatitur. Ishte 5 maji 1926.***" (Ll.B.f.55) Del këtu që greku i dinte gjërat. Pra, ish pjesëtar i konspiracionit. I nisur nga ndjenja njerëzore, ai e quajti për detyrë ta paralajmëronte Shuaipin, por, pse u nis anija para kohe, nuk del e qartë. Fjalia "***Ai fshatari yt le të iki***", na bën të dyshojmë, se mos, ky shok pune i Shuaipit, por grek dhe pjesëtar i konspiracionit, duke e ditur që Shuaipi nuk do të rrinte duarkryq, i ka lajmëruar eprorët e vet dhe ata, para se Shuaipi të gjente varkën, kanë marrë masa që anija të nisej.

"***Po atë ditë***" shkruan Llukani, "***Apostolin e vranë në anije agjentët grekë dhe trupin e tij e hodhën në det.***" (Ll.B.f.55)

Pano Rrumbullaku jep këtë njoftim lidhur me shkuarjen e Apostolit në Havanë dhe mënyrën si është vrarë: "***Aty ai filloi punën për propagandimin e vendit të tij, por***

pa mbushur akoma viti, ra viktimë e urrejtjes së tërbuar të shovinistëvet, të cilët nuk duronin dot që ky njeri, me emrin Apostol, të quhej shqiptar. Pransaj, e therën me thika dhe trupin e tij e hodhën në det." (P.Rr.1978) Llukani thotë: "***E vranë në anije***", por Pandi e ka saktësuar më konkretisht mënyrën se si është kryer ai krim. Shovinizmi i shndërron njerëzit në kriminelë të verbër. Verbërinë shoviniste e shkakton, mbi të gjitha, injoranca. Grekët injorantë të atij ambienti emigrantësh, mendojnë se emrin Apostol mund ta mbajë vetëm një grek dhe, doemos, ata Apostolin e kanë quajtur tradhtar, prandaj dhe urrejtja e tyre ka qenë e shumëfishuar.

"Kur erdhi lajmi në Malëshovë, familja nuk qau me ligje, pasi ai ra për Shqipërinë. Ndërsa populli i ngriti këngë:

'Së gjurmuari s'të lanë,

Të hodhë në oqean!

Kështu ta nxuarr inanë!

Shuaipi na dha lajm'në.

Shuaip Kasua kur erdhi,

I saktë na u dha haberi:

Se ty të hodhë në ujë,

Në detin e madh në Kubë."' (Ll.B.f.55-56)

ATDHEU PËR APOSTOL BARKO-MALËSHOVËN

Në mbyllje të shënimevet të vet, Llukan Barkoja shkruan: "***Këto që janë regjistruar , të shkruara në këtë biografi, të gjitha janë të sigurta e të vërteta. Janë radhitur ashtu si kanë ndodhur në ato kohë të kaluara***." (Ll.B.f.73) "***Unë kam qenë vetë personalisht me Apostolin, që*** (nga) ***ato ditë që u kthye nga lufta,*** (nga) ***Korça, më 1918, deri sa u largua për në Kubë, më 1925. Brenda këtyre viteve punuam bashkë,*** (si) ***marangozë, fshatravet dhe, sa ç'kam shkruar për jetën e punët e Apostolit në këtë biografi, kam qenë bashkë me të.*** (Pra), ***ato që***

kam shkruar këtu, (ose) ***i kam parë me sytë e mi*** (ose) ***i kam dëgjuar nga goja e tij*.”** (Ll.B.f.73)

Shënimet janë përfunduar më 5 janar 1980, jo plot dy vjet para se edhe vetë Llukani të largohej nga jeta. Aty gjendet, midis tjerash, edhe një poezi, e krijuar nga Jano Keqi, njëri prej ndjekësvet më besnikë të rrugës së Apostol Barkos:

“APOSTOL, YLL I NDRIÇUAR”

“Apostol, yll i ndriçuar,
Sa rrojte, ndrite në jetë,
Se nëna të kish kënduar:
‘U bëfsh shqiptar me besë!’

Ti besën kurrë s’e ktheve,
Se për Shqipërinë u rrite,
Ndaj dhe jetën s’e kurseve,
Çdo gjë për Atdhe e trete!

Më ’903 u ktheve,
Nga Mëmëdheu mërguar.
Në Sofje e në Amerikë,
Në çdo vend lëshove dritë.

Ndaj i urreve armiqtë,
Feudalë e shovinistë.
Doje Mëmëdhenë të lirë:

Flamur e shkollë, si gjithë.

Si gjithë Njerëzimi,
Tek Lindja, tek Perendimi,
Se ti pe Botënë mbarë,
Ndaj erdhe, të lëshoje farë.

Kur erdhe nga Amerika,
Kërkove shokë me çika.
Në Shkrelaj bëre folenë,
Besimtarë për Atdhenë.

Brenda në Shkrelaj shkodranë,
Gjete Çeçon, Mustrafanë.
Çerçiz Topullin me famë!
Filluat e bëtë planë.

Kishit punë më t'gjith'anë,
Si me penë, edhe me armë,
Si në Jugë e në Veri,
Gjithë vendi qe në zi.

Prandaj u hodhe në Korçë,
Si u more vesh me shokë,

Sali Butkën e të tjerë,

Me Themistokli Gërmenjnë.

Dhe atje planet i stistë,

Formuat Autonominë,

Korçën me gjithë krahinë,

Të rilindënit Shqipërinë.

Apostol, o trim me mendje!

Erdhi koha ta përmendje

Nga gjumi krahinën tënde:

T'i jepje idenë tënde.

Apostol Barko, me vulë,

Këtu keshe armiq shumë,

Po ti nuk u trembe kurrë,

Erdhe dhe ngrite Flamurë!

Apostol, o trim me pallë!

Çele shkollën shqip të parë,

Mësues vure Dhimitrajnë,

Në Limar vure Saminë,

Mësove shqip gjithë rininë!

Së gjurmuari s'të lanë,

Të hodhë në det, në oqean.

Ashtu ta nxuarr inanë.

Shuaipi na dha lajmnë.

Shuaip Kasua, kur erdhi,

I saktë u dha haberi,

Që tyj të hodhë në ujë,

Në detin e madh në Kubë.

Apostol, o trim dragua!

Shqipëria u çlirua

Dhe u bë shembull në botë,

Se iu rrit një trim me kokë.

Një trim, posi dritë e djellit,

Nga vendi i lashtë i Çerçizit,

I Bajos dhe i Argjirit,

Shpëtimtar i Njerëzimit!

Apostol, o trim i rrallë,

Ti s'ke vdekur, je i gjallë!

Edhe kurrë nuk do të harrohesh,

Brez pas brezi do të kujtohesh!"

Jano Keqi. (Ll.B.f.68)

Shkrimin që ka botuar te gazeta "***Luftëtari***" më 1978, Pano Rrumbullaku e mbyll kështu: "***Ai ra me zemër të zhuritur, sepse nuk e pa Shqipërinë ashtu si e deshi vetë. Fotografitë ruhen së bashku me kujtimin e atyre martirëve që punuan e luftuan për shkrimin shqip, luftë kjo që kishte karakter të thellë politik, prandaj këta patriotë të shquar, që, 70 vjet më parë krijuan shoqërinë "Lidhja Shqiptare", ndër ta edhe Apostol Barko-Malëshova, rrëmbyen armët në duar për të siguruar lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Ai u përpoq për mëmëdhenë për 30 vjet me radhë, i këndoi trimërisë, ra edhe vetë si trim, duke mbetur përherë i pavdekshëm."*** (P.Rr.1978)

Fakti që ky shkrim është botuar më 1978-n, dëshmon që vepra patriotike e Apostol Barkos është vlerësuar në të gjitha kohët, sado që vlerësimi për një veprimtar të tillë, për një luftëtar siç ishte ai dhe për një dëshmor, rënë për Atdhe në rrethana vërtet të jashtzakoshme, nuk është asnjëherë i mjaftueshëm. Apostol Barko-Malëshova e ka merituar, me të gjithë jetën dhe veprën e tij, atributin e një heroi nga më të shquarit e kohës së vet.

Më 5 korrik të 2006-s, në gazetën "***Malëshova***", Simo Tyto, boton një shkrim me titull: "***Apostol Barko Malëshova, atdhetar i madh***". Unë po e ribotoj të plotë këtë shkrim, me vlerën e njërit prej kapitujvet përmbyllës.

"***Lindi në familjen Barka, në katundin Malëshovë, në vitin 1874, një djalë i cili u quajt Apostol. Me vuajtje u rrit, si gjithë bashkëmoshatarët e tij. Pasi mbaroi shkollën fillore në gjuhën greke, në vitin 1899, në moshën 24-vjeçare, shkoi në Bullgari.***

Shumë shpejt integrohet në shoqërinë shqiptare të organizuar në Sofje. Pikërisht këtu nis edhe formimi i vetëdijes kombëtare te Apostol Barkua, e cila kultivohej në Sofje nga shoqëria shqiptare 'Dëshira', nëpërmjet shkollës shqipe, librave shqip dhe punës për përhapjen e shqiptarizmës.

Pas pjesëmarrjes së vazhdueshme në veprimtarinë politike të kësaj shoqërie, Apostoli vendos lidhje të forta me vendlindjen e tij. Mbi të gjitha, kërkonte të përhapte arsimin shqip, librat shqip edhe idetë e atdhedashurisë.

Pasi kthehet në vendlindje, i vetmi shqetësim i tiji ishte përhapja e librave, abetareve e teksteve të tjerë, edhe pse kjo ishte shumë e vështirë, pasi nuk e lejonte regjimi i pushtuesve turq. Duhej guxim, trimëri e vetëmohim, për t'iu

kundërvënë njëherazi, edhe turqve, edhe propagandës antishqiptare të Patriarkanës Greke.

Megjithatë, ai bëri sa mundi, deri në vitin 1906, kur emigroi në Argjentinë, në Buenos Aires. Por, edhe 8 vjet të emigrimit atje, nuk e shkëputën atë nga aktiviteti patriotik. Iu përkushtua tërësisht veprimtarisë së shoqërisë 'Lidhja shqiptare', ku ishte zgjedhur edhe në kryesinë e saj.

Ngritja e Flamurit në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, për të shërbeu si një nxitës i fuqishëm që të kthehej në Atdhe. Dhe kthehet në vitin 1914. Por, për çudinë e tij, kur zbret në Sarandë, në vend të flamurit shqiptar, ai shikon të valëvitet flamuri grek. E pabesueshme dhe zhgënjyese për të.

Kthehet menjëherë dhe, me vapor, i drejtohet Vlorës, ku takohet me patriotë të mëdhenj. Me dhimbje, prej tyre meson për gjëndjen e destabilizuar të Atdheut. Vendos të kthehet në Itali dhe prej andej (të shkonte) në Amerikë. Në Itali bie në kontakt me vëllezërit Topulli, Muço Qulli etj, të cilët e nxitin të udhëtojë drejt Shkodrës.

Por edhe vajtja në Shkodër përkoi me pushtimin e saj nga malazezët. Strehohet në shtëpinë e patriotit të madh Dasho Shkreli. Më pas largohet dhe niset drejt Beratit, ku takohet me 2 patriotë të tjerë të mëdhenj, Sali Butkën dhe Themistokli Gërmenjin. Bashkohet me çetën e Sali Butkës, ku u dallua si luftëtar i denjë në Betejën e Panaritit e në përballjen në Voskopojë me shovinistët grekë.

Në këtë çetë dallohet jo vetëm për trimërinë, por edhe për zgjuarësinë e tij. Në monografinë "Plaku i Butkës" të S. Luarasit thuhet: 'Për të rregulluar mosmarrëveshjet… Plaku i Butkës dërgon Apostolin e urtë.' (Këtë pasazh nuk e gjetëm dot në veprën me të njëjtin titull të S.Godos. Mbetet për t'u kërkuar: A ka vepër me të njëjtin titull të S.Luarasit? Gj.D.)

Nga Korça largohet pa mbaruar Lufta e Parë Botërore. Ai kthehet në Malëshovë, por i gjithë Përmeti dhe vendlindja e tij ishin të pushtuar nga Italia.

Në kokë mbante një qylaf të bardhë, si shprehje e shenjave tona kombëtare.

Takimi me bashkëfshatarët u kthye në një mbledhje të vërtetë me të gjithë burrat e Malëshovës, Limarit dhe Leskajvet.

Mbas disa ditësh, bashkë me motrën e vet, niset për në Përmet. Tek Lisi i Dervishit i zënë pritë andartët grekë, të cilët e fyejnë dhe e torturojnë barbarisht, duke kërkuar të hiqte dorë nga propaganda kundër Greqisë.

Kthehet sërish në Malëshovë, duke pasur vetëm një ide: Të hapte shkollën shqipe. Kjo u bë e mundur më 5 mars 1918. Mësues i parë ishte Dhimitër Notja (Taqe) dhe më pas Sotir Laskua. Në oborrin e shkollës u mblodhën fshatarët e Malëshovës, të Leskajvet e Limarit, pët të festuar këtë ditë të rrallë.

Apostoli ishte gjithashtu organizatori i parë i festimit të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit. Në këtë ditë, në oborrin e shtëpisë së tij, ai ngriti Flamurin Shqiptar, që e kishte sjellë nga Korça. Këtë flamur e ngriti edhe në shkollë, të cilin nxënësit e morën dorë më dorë.

Në 1920-1924 qëndroi në Malëshovë, ku mbështeti fuqimisht shoqërinë 'Bashkimi', të Avni Rustemit.

Në vitin 1925, duke udhëtuar nga Kuba për në Amerikë, spiunët e andartëve grekë e vrasin dhe e hedhin në ujërat e detit.

Është ndër atdhetarët e rrallë, i cili s'ka një varr ku të zhvillohen homazhe për të." (S.T.2006)

Unë mendoj që nuk ka mbyllje më të saktë se kjo: "***Është një ndër atdhetarët e rrallë, i cili s'ka varr ku të zhvillohen homazhe për të***."

Gjokë Dabaj - Durrës, 2013-2017

P A S TH Ë N I E

Shumica e të dhënavet është marrë nga një dorëshkrim i të ndjerit Llukan Barko, djali i madh i Apostol Barkos. Dorëshkrimi ruhet në arkivin familjar të Apostol Llukan Barkos, nipit dhe emërmbajtësit të Apostol Barko-Malëshovës.

Kontributi i të ndjerit Llukan Barko është aq vendimtar në këtë libër, sa ai lirisht do të mund të quhej edhe autori i këtij libri. Unë, në këtë rast, jam thjeshtë një rishkrues i dorëshkrimit që na e ka lënë ai, duke shtuar edhe një tufë të dhënash të tjera, gjithsesi të pamjaftueshme.

Një pjesë e të dhënavet janë marrë nga disa shënime të z.Leonidhë Barko, nipi i Apostol Barko-Malëshovës.

Më kanë shërbyer edhe rrëfimet gojorë të znj.Fotini Dabaj, mbesë e Apostol Barko Malëshovës.

Dhe, përfundimisht, për ta mbyllur këtë libër të vogël, i cili, siç e kemi thënë tashmë disa herë, është tepër i vogël për një personalitet aq të madh, dua të falenderoj z.Trifon Dafa për recenzën e tij të kujdeshme, shoqëruar me fjalë aq të mira në hyrje, dhe z. Fatos Vllamasi, që e shtypi këtë libër duke u mjaftuar që t'i kompensohet vetëm kostoja e të shtypurit.

Gjokë Dabaj

~~~~~~

© Pashtriku.org, Mars 2017
~~~~~~